


Telekomi shkëput
kontratën
me 'Z-Mobile' | FAQE 9



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

OPINION

PROVOKIMI,
ARMË
E MENDJEVE
INFERIORE | F. 9

Nusret PLLANA



AKTUALE



PACOLLI: LUKSEMBURGU
MBETET ALEAT I
RËNDËSISHËM PËR KOSOVËN | F. 5

KOSOVA KA SHËNUAR
PËRPARIM NË MBROJTJEN E TË
DREJTAVE TË KOMUNITETEVE | F. 6

EKONOMI



PRODUKTET 'MADE IN
KOSOVA' SYNOJNË TREGUN
AMERIKAN | F. 9

KOMPANIA NORVEGJEZE,
E INTERESUAR PËR
INVESTIME NË MENAXHIMIN
E MBETURINAVE | F. 8

SPORT

FERONIKELI ME FITORE
SYNON TË DEBUTOJË NË
LIGËN E KAMPIONËVE | F. 24

FLET PËR "EPOKËN E RE", MILAZIM KRASNIQI | FAQE 4-5

Serbia e anuloi Samitin e Parisit, nuk dëshiron marrëveshje me Kosovën



Njohësi i proceseve politike, profesor Milazim Krasniqi, ka vlerësuar se Serbia është fajtores për anulimin e Samitit të Parisit. Ai ka thënë se ky samit nuk u mbajt pasi Serbia nuk dëshiron marrëveshje për njohjen e Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Krasniqi ka deklaruar se Kosova duhet të heqë dorë nga iluzioni për arritjen e marrëveshjes me Serbinë. Ai ka thënë se është e pamundur kjo marrëveshje pa ndryshuar qasja e Bashkimit Evropian ndaj Serbisë. Krasniqi ka theksuar se derisa të hapet rruga e anëtarësimit paralel e Serbisë dhe Kosovës në BE nuk do të ketë dialog për marrëveshje finale. Sipas tij, BE-ja nuk ka fuqi imponuese mbi politikën e Vuçiqit dhe të Beogradit. Krasniqi ka thënë se Kosova duhet të fokusohet në forcimin e institucioneve, në forcimin e identitetit shtetëror, si dhe në forcimin e aleancave me miqtë strategjikë

Mbi 60 për qind e qytetarëve kundër korrigjimit të kufirit Kosovë - Serbi | FAQE 3

Qytetarët e Kosovës nuk e duan korrigjimin e kufirit Kosovë - Serbi. Rezultatet e një hulumtimi të Institutit RIDEA kanë treguar se mbi 60 për qind e qytetarëve nuk e duan korrigjimin e kufirit në këmbim të njohjes reciproke dhe hapjes së rrugës për të marrë Kosova ulëse në OKB. Prezantimi i këtij hulumtimi është bërë në konferencën "Zëri i popullit rreth 'Finaleve të madhe' ndërmjet Kosovës dhe Serbisë", ku presidenti i vendit



dhe zyrtarët më të lartë të opozitës i kanë prezantuar qëndrimet e tyre për procesin e dialogut Kosovë - Serbi

Kuvendi
miraton
raportin që
konstaton
shkelje gjatë
dëbimit të
shtetasve turq | FAQE 3



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANK VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë, Vasa, p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Skenari i opozitës për bllokimin e zgjedhjeve të 30 qershorit

TIRANË, 24 QERSHOR - Opozita ka menduar që me strukturat që kanë tashmë emrin "Aleanca qytetare për mbrojtjen e demokracisë" do t'i bllokojë zgjedhjet e 30 qershorit. Në një komunikim për mediet kjo aleancë nis ngritjen e saj fillimisht në Fier, ku thuhet se do të

zyrtarizohet dhe se në përbërje të saj janë personalitete dhe intelektualë të Fierit, mes të cilëve mjekë, mësues, inxhinierë, avokatë, noterë, biznesmenë e shumë fusha të tjera. Në deklaratën për shtyp të Partisë Demokratike, thuhet se në zbatim të vendimit të

Këshillit Kombëtar të Partisë Demokratike, dega e PD-së Fier, në bashkëpunim me partitë e tjera opozitare, ka ngritur Aleancën qytetare për mbrojtjen e demokracisë. Në këtë forum qytetar janë bashkuar Aleanca qytetare për mbrojtjen e demokracisë së

bashku me strukturat lokale të partive të opozitës do t'i drejtohen KZAZ dhe Bashkisë Fier për ta kërkuar lirimin e ambienteve që mbahen në mënyrë të paligjshme duke kërkuar që të vihet në zbatim dekreti i presidentit të Republikës dhe ndalimi i një procesi farsë zgjedhor



më 30 qershor, përfundon deklarata e Partisë Demokratike.

Kolegji Zgjedhor rrëzon dekretin e Metës, zgjedhjet më 30 qershor

Duke njohur si të drejtë vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, lidhur me kërkesën e Partisë së Unitetit Kombëtar, Kolegji Zgjedhor ka njohur 30 qershorin datë të zhvillimit të zgjedhjeve vendore

TIRANË, 24 QERSHOR - Kolegji Zgjedhor në Shqipëri i dha të hënën të drejtë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) i cili e konsideroi të pavlefshëm dekretin e presidentit Ilir Meta për anulimin e 30 qershorit si datë të zgjedhjeve vendore dhe vijoi me përgatitjen e procesit. Kolegji u vu në lëvizje nga Partia e Unitetit Kombëtar (PUK), pasi kjo forcë politike i kërkoi të çregjistrohej nga pjesëmarrja në zgjedhje, duke qenë se kreu i Shtetit kishte vendosur anulimin e 30 qershorit. Por KQZ-ja e kishte rrëzuar këtë

kërkesë. Duke e njohur si të drejtë vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, lidhur me kërkesën e Partisë së Unitetit Kombëtar, Kolegji praktikisht ka njohur 30 qershorin datë të zhvillimit të zgjedhjeve vendore. Argumentet juridikë, mbi bazë të të cilave Kolegji mori vendimin e sotëm, nuk janë bërë të ditura dhe pritet të zbulohen në ditët e ardhshme, kur të publikohet vendimi i arsyetuar i Kolegjit.

Opozita shqiptare kishte vlerësuar paraprakisht se Kolegji, sipas saj, nuk kishte kompetencën për



ta vlerësuar dekretin e presidentit, i cili, sipas saj, mund të interpretohet vetëm nga Gjykata Kushtetuese, e cila është jashtë funksionit për momentin. Nga ana e saj shumica e majtë i është

referuar një vendimi të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese të vitit 2017 që, sipas saj, e cilëson dekretin e presidentit një akt individual administrativ.

Në një reagim të tij, menjëherë

pas vendimit të Kolegjit, zëdhënësi i presidentit, Tedi Blushi, shprehet se akti i sotëm nuk përbën "asnjë surprizë nga skeçi i radhës i orkestruar prej kohësh". Ndërsa presidenti i Republikës, Ilir Meta, ka njoftuar një konferencë të jashtëzakonshme për shtyp sot (e martë) në orën 8:00. Vendimi vjen pasi të hënën Kolegji vendosi në një farë mënyrë ta rrëzonte dekretin e kreut të shtetit për anulimin e zgjedhjeve, duke hedhur poshtë kërkesën e partisë së Idajet Beqirit për t'u çregjistruar.

Burimet bëjnë me dije se konferenca do të mbahet sot (e martë) në mëngjes në orën 08:00 në ambientet e Presidencës. Nuk dihet nëse në konferencë do të jetë presidenti i Republikës apo këshilltarët e tij.

Daçiç: Nuk është kompromis që Serbia ta njohë Kosovën në tërë territorin e saj



BEOGRAD, 24 QERSHOR - Ministri i Jashtëm i Serbisë, Ivica Daçiç, tha se zgjidhja e kompromisit për çështjen e Kosovës nuk mund të nënkuptojë që Serbia ta pranojë pavarësinë e Kosovës në tërë territorin e saj. "Për ne tani është e rëndësishme të gjejmë një zgjidhje kompromisi. Kjo zgjidhje nuk mund të bëhet me detyrim, që Serbia ta njohë Kosovën shtet

të pavarur në tërë territorin e saj. Ky nuk mund të jetë kompromis", tha Daçiç të hënën. Ai tha se Serbia nuk paraqet asnjë pengesë për vazhdimin e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën, porse kërkon të hiqet taksa 100 % që Kosova ua ka vënë prodhimeve të importuara nga Serbia.

Dialogu midis palëve është

ndërprerë prejse Kosova e ka marrë vendimin për këtë taksë në nëntor të vitit të kaluar. Qeveria e Kosovës, e udhëhequr nga kryeministri Ramush Haradinaj, ka thënë se taksa nuk do të hiqet derisa Serbia nuk e njeh Kosovën.

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiç, ka thënë se dialogu me Kosovën nuk mund të vazhdojë pa u hequr kjo taksë.

Fitore vendimtare e opozitës në Stamboll

ANKARA, 24 QERSHOR - Në Turqi opozita arriti një fitore vendimtare në rivotimin e debatueshëm të zgjedhjeve për kryebashkiak të Stambollit, duke i shkaktuar një disfatë të ndjeshme presidentit Rexhep Tajip Erdogan. Fitorja nënkupton humbjen e bazës së pushtetit në Stamboll për Erdoganin që ai e mbante prej 25 vjetësh.

Kreu i Bordit të Lartë Zgjedhor njoftoi të hënën se Ekrem

Imamoglu i Partisë Popullore Republikane, një parti laike e njohur si CHP, siguroi 54.21 % të votave, një diferencë shumë më e madhe votash sesa fitorja e tij e ngushtë tre muaj më parë ndaj kandidatit Binali Yildirim, të përzgjedhur nga vetë presidenti Erdogan. Kjo përkthehet në rreth 700 mijë vota më shumë krahasuar me diferencën prej vetëm 13 mijë në votimet e 31 marsit.

Duke folur para një turme të

madhe mbështetësish entuziastë, Imamoglu tha se fitorja e tij ishte një nxitje për demokracinë. "Kjo shoqëri do të shpërblehet me shumë liri. Kjo shoqëri do t'i ndreqë shkeljet e bëra. Do ta shihni. Unë kam besim te populli ynë. Besoj, gjithashtu, se njerëzit kanë besim te demokracia. Falënderoj presidentin tonë, Tajip Erdogan dhe rivalin tim, të cilët më uruan", tha ai.

Presidenti Erdogan e uroi

Imamoglu me një koment në "Twitter", ku shkruante: "Vullneti i popullit u shfaq përsëri".

Erdogani bëri që autoritetet zgjedhore ta anulonin fitoren e parë të Imamoglus me arsyen teknike se vëzhguesit zgjedhorë ishin të pakualifikuar. Presidenti rrezikoi prestigjin e tij politik në këtë rivotim. Megjithatë, zgjedhësit, shumë prej të cilëve ndërprejnë pushimet për t'u kthy-



er dhe për të votuar, mbështetën mesazhin e Imamoglut për demokracinë dhe pjesëmarrjen politike.

Ngritja e Erdoganit në pushtet nisi me fitoren e tij në zgjedhjet bashkiake të Stambollit në vitin 1994.

Instituti Kërkimor për Çështje Evropiane dhe të Zhvillimit (RIDEA) ka organizuar konferencën "Zëri i popullit rreth 'Finales së madhe' ndërmjet Kosovës dhe Serbisë"

Mbi 60 për qind e qytetarëve kundër korigjimit të kufirit Kosovë - Serbi



Qytetarët e Kosovës nuk e duan korigjimin e kufirit Kosovë - Serbi. Rezultatet e një hulumtimi të Institutit RIDEA kanë treguar se mbi 60 për qind e qytetarëve nuk e duan korigjimin e kufirit në këmbim të njohjes reciproke dhe hapjes së rrugës për të marrë Kosova ulëse në OKB. Prezantimi i këtij hulumtimi është bërë në konferencën "Zëri i popullit rreth 'Finales së madhe' ndërmjet Kosovës dhe Serbisë", ku presidenti i vendit dhe zyrtarët më të lartë të opozitës i kanë prezantuar qëndrimet e tyre për procesin e dialogut Kosovë - Serbi

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 24 QERSHOR - Mbi 60 për qind e qytetarëve të Kosovës nuk e mbështesin korigjimin e kufijve Kosovë - Serbi. Sipas një hulumtimi të Institutit RIDEA, të prezantuar të hënën në konferencën "Zëri i popullit rreth 'Finales së madhe' ndërmjet Kosovës dhe Serbisë", 55 për qind e kosovarëve janë absolutisht kundër një korigjimi të kufijve në këmbim të njohjes nga Serbia dhe hapjes së rrugës që Kosova të marrë ulëse në OKB. 5.8 për qind e qytetarëve mendojnë se "ndoshta nuk duhet" që Kosova dhe Serbia t'i korigjojnë kufijtë në këmbim të njohjes globale të Kosovës. Ndërsa, vetëm 5.2 për qind e qytetarëve, sipas hulumtimit, mendojnë se "definitivisht duhet" që Kosova dhe Serbia t'i korigjojnë kufijtë për të gjetur

një zgjidhje politike mes tyre. Në konferencën ku është bërë publikimi i këtij hulumtimi, kanë marrë pjesë përfaqësuesit e pushtetit dhe të opozitës, të cilët kanë vazhduar t'i paraqesin qëndrimet e tyre të ndryshme rreth kësaj çështje. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se përmbyllja e dialogut politik me Serbinë, me marrëveshje ligjrisht obliguese, që nënkupton njohje reciproke, është interes kombëtar i Kosovës. "Nuk kam kurrfarë dyshimi që marrëveshja mund të arrihet këtë vit, marrëveshje ligjrisht obliguese në mes të Kosovës dhe Serbisë, por nëse nuk ndodh, do të hyjmë në një fazë të rrezikshme të këtyre raporteve, e cila edhe mund t'i destabilizojë jo vetëm raportet tona si dy shtete, por edhe rajonin", është shprehur presidenti.

Thaçi ka thënë se Kosova është e

gatshme për dialog në mënyrë që njëherë e përgjithmonë të qartësohet raportin me shtetin e Serbisë. "Fatkeqësisht, situata dhe zhvillimet e fundit nuk janë aspak premtuese. Gjërat nuk po lëvizin fare dhe aktualisht jemi duke vendnumëruar. Pavarësisht prej iniciativave të fundit për ta zhbllokuar dialogun, rezultati është zero. Mungesa e dialogut dhe perspektivës për arritjen e një marrëveshjeje për normalizimin e raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë është rreziku më i madh i mundshëm për sigurinë e stabilitetit për të dy vendet dhe rajonin", ka shtuar Thaçi.

Presidenti Thaçi ka ritheksuar që opsioni i ndryshimit të kufirit apo demarkimit të kufirit ka siguruar përkrahjen më të madhe të qytetarëve të Kosovës, me gjithë fushatën negative të partive politike ndaj këtij skenari. "Është për keqardhje që klasa politike koso-

vare po dështon të bashkohet për ta bërë realitet idealin e bashkëdhjetarëve tanë të Luginës së Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit që t'i bashkëngjiten Kosovës", ka thënë presidenti. Kurse kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka thënë se plani i Serbisë për ndarjen e Kosovës ka dështuar. Mirëpo, sipas tij, ideja për këtë çështje ende është e gjallë. "Në Serbi është quajtur kufizim kufiri, ndërkaq në Kosovë është quajtur korigjim i kufirit me kompromise të dhimbshme. Kemi arsye për gëzim, por jo edhe për festim. Pra, gëzim pa festë sepse ideja nuk ka vdekur", ka thënë Kurti, duke shtuar se korigjimi duhet të vijë pas pranimit të Kosovës në OKB. "E kam një propozim shumë të thjeshtë, le ta bëjmë njëherë anëtarësimin në OKB, njohjen e Kosovës, pastaj e bëjmë korigjimin, shohim a ka hapësirë, e jo një herë korigjimi pastaj anëtarësimi", ka deklaruar Kurti.

Pjesë e kësaj konference ka qenë edhe nënkryetari i LDK-së, Lutfi Haziri, i cili ka thënë se subjekti i tij politik kërkon zgjedhje të reja para fazës finale të dialogut me Serbinë. "Ne si LDK kemi thënë prej fillimit: kritere, parime në negociata dhe qartësi në proces. Ne kemi bërë hapin tjetër, legjitimitet para dialogut.

Shqetësimi im është që Serbia mund ta marrë datën për në BE", ka deklaruar ai, duke shtuar se më pas procesi i integritetit të Kosovës mund të ngeçë. "Jo zgjedhje për të hyrë në qeveri me çdo kusht, por zgjedhje që përcaktojnë zgjidhje për qytetarët sepse Kosova sot është e paudhëhequr me përgjegjësitë e pritura. Vendimet e partive po na shtyjnë drejt një populizmi që nuk kanë me na shty drejt zgjidhjeve për vendin. Kosovës i intereson një stabilitet i brendshëm dhe normalizim i raporteve me fqinjët por, mbi të gjitha, duhet të na interesojë një stabilitet i brendshëm", ka thënë Haziri.

Kurse kryetari i PSD-së, njëherësh bashkëkryesues i ekipit negociator të Kosovës, Shpend Ahmeti, ka fajësuar tre liderët institucionalë të vendit për qëndrime kontroverze për dialogun. "Patëm shfaqje nga kryeministri, se nuk merret me dialog, e tash kaloi në një protagonizëm individual, por me idenë që ai duhet të jetë bartës i proceseve të tilla. Kemi diskutime kontroverze mes krerëve të shtetit. Është vështirë të shkohet në Bruksel, ku pyetjet kryesore janë se çka ka thënë ai e çka ky. Nuk është arsye e ndërprerjes së dialogut taksa, por mospajtimi ndërkombëtar mbi procesin", ka deklaruar Ahmeti.

Edhe një ish-ushtar i UÇK-së ftohet nga Specialja

PRISHTINË, 24 QERSHOR (ER) - Ish-ushtari i UÇK-së, Muhamet Krasniqi, është ftuar nga Gjykata Speciale në

cilësinë e të dyshuarit për krime lufte. Në një konferencë për media mbajtur të hënën, Krasniqi ka thënë se

do t'i përgjigjet festës së ardhur më 20 qershor, edhe pse nuk e di arsyen e kësaj ftese. Muhamet Krasniqi ka

shërbyer në zonën e Pashtrikut. Ndërkaq Nasin Haradinaj, nënkryetar i OVLUÇK-së, ka thënë se të

gjithë ushtarët që marrin ftesa të tilla të lajmërohen në OVLUÇK dhe t'u përgjigjen ftesave të kësaj gjykate.

Flet për "Epokën e re", Milazim Krasniqi

Serbia e anuloi Samitin e Parisit, nuk



Njohësi i proceseve politike, profesor Milazim Krasniqi, ka vlerësuar se Serbia është fajtores për anulimin e Samitit të Parisit. Ai ka thënë se ky samit nuk u mbajt pasi Serbia nuk dëshiron marrëveshje për njohjen e Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Krasniqi ka deklaruar se Kosova duhet të heqë dorë nga iluzioni për arritjen e marrëveshjes me Serbinë. Ai ka thënë se është e pamundur kjo marrëveshje pa ndryshuar qasja e Bashkimit Evropian ndaj Serbisë. Krasniqi ka theksuar se derisa të hapet rruga e anëtarësimit paralel e Serbisë dhe Kosovës në BE nuk do të ketë dialog për marrëveshje finale. Sipas tij, BE-ja nuk ka fuqi imponuese mbi politikën e Vuçiqit dhe të Beogradit. Krasniqi ka thënë se Kosova duhet të fokusohet në forcimin e institucioneve, në forcimin e identitetit shtetëror, si dhe në forcimin e aleancave me miqtë strategjikë

arrihet një marrëveshje përfundimtare në mes të Kosovës dhe Serbisë. Nëse dikujt i ngutet për marrëveshje atëherë i ngutet Serbisë sepse me kapitullin e 35-të të BE-së Serbia është e kushtëzuar të ketë marrëveshje me Kosovën para çfarëdo lëvizje drejt anëtarësimit, ndërsa Kosova është shumë më larg në procesin e integritimit evropian. Prandaj, mendoj se Kosova mund të luajë rol ndikues me bllokim sesa me këtë entuziazëm naiv lidhur me dialogun. Këtë entuziazëm naiv të përfaqësuesve tanë serbët e kanë shfrytëzuar për t'u thelluar më tepër në ndërhyrjen e punëve të Kosovës dhe për ta dëmtuar imazhin e Kosovës.

"Epoka e re": Ndonëse në kohët e fundit në opinion u krijua një optimizëm për arritjen e një marrëveshje eventuale ndërmjet dy vendeve, ka pasur shpresë se në Samitin e Parisit mund të vendosen bazat e saj, por pas këtyre zhvillimeve, sa ka gjasa të ndodhë një gjë e tillë?

Krasniqi: Personalisht nuk pres absolutisht se mund të arrihet marrëveshje me Vuçiqin i cili, në betimin e tij si president, ka deklaruar se 'me çdo forcë do ta mbrojë Kosovën brenda Serbisë' si dhe ditë më parë ka thënë se 'edhe nëse vijnë 350 milionë amerikanë, unë nuk do ta njoh Kosovën'. Unë nuk e di nëse përfaqësuesit tanë i lexojnë drejt dhe nëse i kuptojnë mesazhet e tij. Mesazhet e presidentit Vuçiq janë aneksioniste dhe destabilizuese, prandaj me këtë person kurrë nuk mund të arrihet një marrëveshje e favorshme për Kosovën.

"Epoka e re": Duke pasur parasysh këto që po i thoni, mendoni se do të ketë vazhdim të dialogut dhe, nëse po, cila do të jetë ecuria e këtij procesi?

Krasniqi: Unë besoj se do të ketë vazhdim të iluzionit lidhur me dialogun, por nuk do të ketë dialog për marrëveshje. Mund të ketë dialog për çështje të veçanta siç ka qenë procesi i Brukselit, mirëpo dialog për marrëveshje finale për t'u pran-

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 24 QERSHOR -

"Epoka e re": Profesor, si e komentoni dështimin e Samitit të Parisit dhe cila mendoni se ka qenë arsyeja kryesore për mosmbajtjen e tij?

Krasniqi: Vuçiqi dhe qeveria e tij luajnë lojë propagandistike lidhur me dialogun por, në fakt, ata janë bllokues të këtij procesi. Takimi i Parisit është anuluar për arsyen e vetme se Vuçiqi dhe Qeveria e Serbisë nuk duan

marrëveshje me Kosovën në bazë të realitetit që ekziston, por marrëveshje që mundëson aneksimin e veriut dhe paralizimin e jugut, marrëveshje që hap rrugën e copëtimit të Kosovës dhe që e amnistion gjenocidin serb. Marrëveshje që hap rrugë për krijimin e Serbisë së Madhe, duke shkëputur edhe Republika Srpskan. Pra, është programi i kriminelëve të vjetër. Nëse nuk duan ta kuptojnë këtë gjë kaq të thjeshtë, Merkel, Makroni dhe të gjithë të tjerët mund të

bëhen kontribuues të destabilizimit të vet Evropës. Ata duhet ta mbyllin lojën me zjarr e jo t'i fryjnë zjarrin.

"Epoka e re": Pas këtij dështimi, çfarë qasje duhet të ketë Kosova ndaj procesit të dialogut?

Krasniqi: Kosova duhet të fokusohet në forcimin e institucioneve të veta, në forcimin e identitetit shtetëror, në forcimin e aleancave me miqtë strategjikë dhe të lihet kjo propagandë iluzioniste se, gjoja, mund të

dëshiron marrëveshje me Kosovën

ndryshime substanciale në Serbi dhe derisa Bashkimi Evropian nuk e ndryshon qasjen radikalisht ndaj Serbisë.

"Epoka e re": *Pati një shpresë se gjërat mund të lëvizin në drejtimin e duhur me një rol aktiv të Francës dhe Gjermanisë në këtë proces, por me mosmbajtjen e Samitit të Parisit, a do të thotë se këto vende kanë dështuar dhe BE-ja nuk ka fuqi për zgjidhjen e problemit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë?*

Krasniqi: Bashkimi Evropian me krizat e brendshme që ka është i pafuqishëm për të imponuar një agjendë imponuese për Serbinë me këtë politikë që ka. BE-ja ka kapacitete për t'i bërë presion Serbisë, por nuk po i bën. Pra, nuk po i bën presion me iluzionin që ta mbajë në proces

për ta shkëputur disi nga Rusia dhe ky është po ashtu një iluzion shtesë sepse Serbia tashmë është shndërruar në shtet vasal të Rusisë. Vuçiçi vazhdimisht deklaroi se para çdo vendimi e telefonon Putinin dhe merr mendimin e tij dhe kjo i bie se ai është vasal i Putinit dhe BE-ja nuk ka fuqi imponuese mbi politikën e Vuçiçit dhe të Beogradit. Prandaj, politikanët tanë duhet ta kuptojnë këtë realitet, duhet të fokusohen në fuqizimin e shtetit të Kosovës, në rritjen e partneritetit me Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut dhe Malin e Zi dhe në proceset integruese në NATO e BE. Vetëm një fuqizim i tillë substancial i Kosovës dhe shqiptarëve mund të shndërrohet në rrethanë për t'ia imponuar Serbisë ndonjë lëvizje nga qëndrimi i tanishëm armiqësor që ka ndaj Kosovës.

"Epoka e re": *Jeni optimist se nëse do të ketë një rol aktiv të Shteteve të Bashkuara të Amerikës do të mund të gjendej një zgjidhje e qëndrueshme në mes të dy vendeve?*

Krasniqi: Deri tash ai ka qenë një qëndrim konfuz dhe qëndrim që realisht më shumë ka inkurajuar lëvizjen e Serbisë drejt Rusisë sesa drejt BE-së. Unë besoj se administrata amerikane do ta kuptojë se kjo është një politikë e gabueshme e presionit mbi Kosovën dhe lajkatimit të Serbisë. Kështu që, nëse kjo nuk ndryshon, do të vijë deri tek ashpërsimi i diskursit politik dhe veprimit në Serbi, si dhe kjo do ta destabilizonte në mënyrë të rrezikshme rajonin. Pra, edhe politika e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në këtë raport duhet të ndryshojë.

"Epoka e re": *Z. Krasniqi, nëse vazhdohet me këtë status kohë, çfarë do të ndodhë me Kosovën?*

Krasniqi: Me këtë status quo Kosova duhet të mësohet të jetojë siç jetojnë jo pak shtete që kanë konteste me fqinjët. Kontest me fqinjët ka edhe Gjeorgjia, por është shtet i pavarur. Kontest me fqinjët ka edhe Ukraina, por është shtet i pavarur. Konteste kanë edhe Greqia me Turqinë, por janë shtete të pavarura. Kosova nuk duhet të sillet si fëmijë idhnak që hidhërohet për lodra dhe derisa nuk pajtohet, përplas këmbët. Duhet ta kuptojmë se Serbia është një shtet armiqësor dhe nuk është e gatshme ta pranojë Kosovën, prandaj duhet të fokusohemi në forcimin e shtetit, forcimin e kombit shqiptar dhe në forcimin e integriteteve euroatlantike.

Pacolli: Luksemburgu mbetet aleat i rëndësishëm për Kosovën

PRISHTINË, 24 QERSHOR (ER) - Zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli, ka pritur të hënën në takim ambasadorin e Luksemburgut në Kosovë, Paul Schmit, me të cilin ka diskutuar për përkrahjen e procesit të integritetit. Me këtë rast, ministri Pacolli ka

çmuar rolin e Luksemburgut në përkrahjen dhe donacionet për shtetndërtimin e Republikës së Kosovës, duke shtuar se reformat dhe fuqizimi i administratës dhe asistencën për zbatimin e MSA-së janë pikat e forta të kësaj përkrahjeje. Po ashtu, ministri ka falënderuar ambasadorin Schmit për vazhdimin e mbështetjes së

Luksemburgut në synimin e Kosovës për t'u anëtarësuar në Interpol dhe në organizatat e tjera ndërkombëtare. "Me përkrahjen tuaj dhe me angazhimin tonë ne besojmë fuqishëm dhe presim që së shpejti të bëhemi aleat i juaji i fortë në BE, NATO dhe në aleancat e tjera demokratike", është shprehur Pacolli.

Ndërsa ambasadori i Luksemburgut në Kosovë, Paul Schmit, ka theksuar rëndësinë e zbatimit të MSA-së si dhe reformën gjithëpërfshirëse e cila rezulton jo vetëm me liberalizimin e vizave, por edhe me proceset e tjera integruese si anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare si dhe procesin euroatlantik.

uar Kosova shtet nga Serbia nuk do të ketë derisa të hapet rruga e anëtarësimit paralel të Serbisë dhe Kosovës në Bashkimin Evropian (BE). Vetëm nëse këto shtete do të futeshin brenda do të ndërrojnë diskutimi dhe diskursi për arritjen e ndonjë marrëveshjeje. Me këtë Serbi, e cila në njërin anë është e lidhur me Rusinë dhe Kinën, ndërsa në anën tjetër luan lojë me Brukselin, nuk mund të arrihet marrëveshje për njohjen e Kosovës shtet.

"Epoka e re": *Si i tillë, ky dialog do të duhet të mos vazhdojë?*

Krasniqi: Përfaqësuesit e Kosovës duhet të flasin për dialog në raport me ndërkombëtarët sepse ata kanë qejf ta dëgjojnë atë muzikë, por nuk duhet të ushqejnë iluzione te populli ynë se mund të arrihet marrëveshja. Përkundrazi, duhet t'ia tregojnë të vërtetën që me këtë Serbi jemi në konflikt dhe ky konflikt nuk është mbyllur dhe nuk mund të mbyllet përderisa nuk ka



Promovohet pulla postare me figurën e ish-presidentit amerikan Woodrow Wilson

PRISHTINË, 24 QERSHOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka marrë pjesë të hënën në promovimin e ekspozitës dhe pullës postare me portretin kushtuar 100-vjetorit të Konferencës së Parisit dhe angazhimit të presidentit amerikan Woodrow Wilson dhe qeverisë amerikane për t'i mbrojtur të drejtat dhe integritetin territorial të Shqipërisë. Me këtë rast, kryeministri Haradinaj ka thënë se në kuadër të përvjetorëve të rëndësishëm të jetës tonë si Kosovë, por edhe të kombit tonë, ka pasur nderin që para pak ditësh të priste në Kosovë presidentin e Amerikës, Bill Clinton, sekretaren Madeleine Albright, gjeneralin Wesley Clark dhe se Kosova i ka nderuar këto figura

kyçe të Amerikës në zbatim të pullës postare. Kryeministri Haradinaj ka bërë me dije se në atë kohë është vënë në dijeni se një nderim i këtillë do të bëhet edhe për presidentin Wilson duke pasur parasysh rolin e tij të rëndësishëm në një periudhë të rëndësishme të historisë së kombit tonë. "Mendoj se një sjellje e këtillë e jona falënderuese dhe shprehja e respektit buron po ashtu nga ajo që përjetuam në vitin '99, kur Amerika i priu NATO-s, duke ndërhyrë dhe ndaluar tragjedinë. Kjo ndërhyrje bëri që populli i Kosovës të shpëtohet, jeta e njerëzve të pafajshëm të shpëtohet, të rikthehet shpresa", ka thënë kryeministri Haradinaj, duke theksuar se aeroplanët e



jetës i ndalen trenat e vdekjes dhe tragjedinë në Kosovë. Kjo ndalje e kësaj tragjedie, siç veçoi kryeministri Haradinaj, është një vepër e mirë së pari

për shqiptarët dhe se ky veprim i NATO-s i ka bërë një nder të madh edhe popullit serb, duke e shpëtuar nga një krim më i madh se ai që e kishte bërë deri

atëherë e që do të ishte një njollë më e zezë për historinë e popullit serb. "Mendoj se falënderimin më të madh Amerikës duhet t'ia bëj populli serb dhe Serbia, sepse Amerika nuk e la të ecë në rrugën e kimit e cila do të ishte e keqja më e madhe që do të mbahej në mend në historinë e njerëzimit pas Luftës së Dytë Botërore. Duke qenë kështu, ndodhën dy të mira: u shpëtua populli i Kosovës, por u ndal edhe një e keqe", ka deklaruar Haradinaj. Një fjalë rasti ka mbajtur edhe kryeshefi ekzekutiv i Postës së Kosovës, Sejdi Hoxha, ndërkaq të pranishëm ishin edhe ministri, deputetë, personalitete nga jeta politike dhe shoqërore si dhe përfaqësues nga Ambasada Amerikane.

Kosova ka shënuar përparim në mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve

EPOKA
ERE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 24 QERSHOR - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, mori pjesë të hënën në pritjen e organizuar me rastin e 24 qershorit, e shpallur nga Qeveria e Kosovës si Dita Memoriale e Komunitetit Egjiptian në Republikën e Kosovës e cila po mbahet në kuadër të Javës së Egjiptianëve. Kryeministri Haradinaj fillimisht ka zhvilluar një takim me përfaqësuesit e këtij komuniteti të cilët i ka falënderuar për kontributin që kanë dhënë për Kosovën në të gjitha proceset. Ndërkaq, në pritjen për nder të këtij komuniteti, pasi ka falënderuar të gjithë për praninë, kryeministri Haradinaj ka theksuar se ndihet i nderuar që në Kosovë tani ka një datë ligjore të shpallur nga Qeveria e Kosovës, duke iu uruar këtij komuniteti këtë datë. "Komuniteti egjiptian është pjesë e jetës sonë, e vendit



tonë dhe me të drejtë e gëzon edhe datën e vet. Vërtet kemi arritur disa suksese sa i përket komunitetit egjiptian në Kosovë. Në kabinetin qeverisës kemi dy këshilltarë, njëri është i përhershëm politik, tjetri është për tema të dialogut dhe për tema të të drejtave të komuniteteve. Kemi dy zëvendësministra por, nuk mjafton", ka thënë kryeministri Haradinaj, duke theksuar se kemi një gjendje të vështirë në punësim, me

shpresën se do ta përmirësojnë bashkërisht. Ndër të tjera, kryeministri Haradinaj ka pohuar se ka vështirësi në çështjen e zgjidhjes së të drejtës së banimit. Sipas kryeministrit Haradinaj, Kosova është krijuar bashkërisht falë edhe kontributit të këtij komuniteti. "Paqen, shtetësinë dhe demokracinë po i krijojmë bashkë. Jemi partnerë të koalicionit qeverisës", ka thënë Haradinaj.

Ambasadori i OSBE-së në Kosovë, Jaan Braathu, ka thënë se legjislacioni dhe Kushtetuta e Kosovës parashohin më të mirën për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve, duke shtuar se duhet punuar së bashku në mënyrë që ta zbatohet ajo edhe pse, siç ka thënë ai, është bërë përparim në vitet e fundit. Deputeti i Kuvendit të Kosovës, Veton Berisha, pasi ka falënderuar kryeministrin Haradinaj

dhe Qeverinë e Kosovës për shpalljen e Ditës Memoriale të Egjiptianëve, ka thënë se ndihet jashtëzakonisht mirë dhe i lumtur që në historinë e komunitetit egjiptian, pikërisht në periudhën e tij si politikan dhe përfaqësues i këtij komuniteti, po ndodhin gjëra të bukura të cilat komunitetit egjiptian në Ballkan i kanë munguar. "Komuniteti egjiptian ka nevojë për afërsi institucionale, i duhet dora e shtetit, i duhet dora e mundësisë që të mbijetojë dhe të qëndrojë vetëm në kuptimin që komuniteti egjiptian është i gatshëm të marrë përgjegjësi të reja", ka thënë deputeti Berisha. Deputeti i Kuvendit të Maqedonisë së Veriut, Rubin Zemon, ka shprehur kënaqësinë që sot ishte i pranishëm në një çast të cilin ai e quajti historik për komunitetin egjiptian në Kosovë, duke theksuar se Kosova është lidere në rajon për respektimin e komuniteteve dhe integrimin e tyre.

Lumezi dhe Peci, pjesë e Konferencës Ndërkombëtare të Kryetarëve të Gjykatave Supreme në Budvë

BUDVË, 24 QERSHOR (ER) - Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, është duke marrë pjesë në Konferencën Ndërkombëtare të Kryetarëve të Gjykatave Supreme dhe Prokurorëve të Përgjithshëm e cila po mbahet në Budvë të Malit të Zi. Qëllimi i kësaj konference treditore, në të cilën janë duke

marrë pjesë kryetarë të gjykatave supreme, prokurorë të përgjithshëm dhe përfaqësues të institucioneve të drejtësisë nga ShBA-ja, Austria, Hungaria, Turqia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Shqipëria, Kosova, Kroacia, Lituania dhe Sllovenia, është diskutimi për mbrojtjen penale juridike dhe mekaniz-

mat e luftës kundër terrorizmit, migracioneve të paligjshme si dhe koordinimi i ndihmës dhe bashkëpunimit juridik ndërkombëtar ndërmjet shteteve pjesëmarrëse. Në këtë kontekst, kryeprokurori Lumezi para fillimit të kësaj konference është takuar me kryeprokurorët nga Turqia, Sllovenia, Mali i Zi,



Shqipëria, Austria dhe Hungaria. Ndërsa pjesëmarrës nga delegacioni i Kosovës në

këtë konferencë është edhe kryetari i Gjykatës Supreme, Enver Peci.

Kuvendi miraton raportin që konstaton shkelje gjatë dëbimit të shtetasve turq



Kuvendi i Kosovës në një seancë të jashtëzakonshme ka miratuar të hënën raportin e Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me rastin e dëbimit të gjashtë shtetasve turq më 29 mars të vitit 2018, ku janë identifikuar 31 shkelje. Raporti është miratuar me 59 vota për, dy kundër dhe katër abstenime

**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 24 QERSHOR - Në një seancë të jashtëzakonshme, Kuvendi i Kosovës ka miratuar të hënën raportin e Komisionit Hetimor Parlamentar për dëbimin e gjashtë shtetasve turq në mars të vitit 2018. Me gjithë kritikën dhe kundërshtimet që u dhanë gjatë debatit nga deputetë të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe grupit parlamentar 6+, raporti u miratua me 59 vota për, dy kundër dhe katër abstenime. Duke prezantuar gjetjet e raportit, kryetari i Komisionit Hetimor Parlamentar, Xhelal Sveçla, ka thënë se janë identifikuar 31 shkelje në procesin e, siç ka thënë, jashtëligjshëm të dëbimit të gjashtë shtetasve turq. Duke u thirrur në raportin hetimor, Sveçla ka pohuar se vendimi për revokim të lejeqendrimeve në Kosovë dhe urdhri për dëbim me forcë të shtetasve turq ishin në kundërshtim me ligjet, Kushtetutën e Kosovës dhe konventat ndërkombëtare. "Në raportin që kemi dorëzuar kemi identifikuar 31 shkelje, të cilat janë të njohura tashmë, si

dhe një listë rekomandimesh për Kuvendin e Kosovës. Po ashtu, duhet theksuar se në kuadër të këtyre shkeljeve, vendimet për revokim të lejeqendrimit dhe urdhrat për largim me forcë janë nxjerrë jashtëligjshëm, e këtë e konfirmojn edhe vendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti Administrativ, e cila ka anuluar këto vendime", është shprehur Sveçla. Ndërkaq deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Driton Selmanaj, ka theksuar se kjo ngjarje është rasti më eklantant i shkeljes së çdo norme dhe dispozite ligjore e kushtetuese nga autoritetet shtetërore. Ai ka thënë se gjatë operacionit Agjencia Kosovare për Inteligjencë (AKI) ka tejkalluar mandatin e saj duke kryer autorizime policore. "AKI-ja ka marrë autorizime policore, ka tejkalluar mandatin e saj kushtetues, në zyrat e Policisë së Kosovës kanë hyrë agjentë të AKI-së dhe kanë menaxhuar operacionin policor. Policia në terren nuk ka komunikuar me përgjegjësit e tyre, shefat e tyre, kanë komunikuar me dy agjentë të AKI-së, atyre u kanë dhënë llogari, me ata janë

konsultuar. Kjo tregon se siguria individuale dhe kombëtare në Kosovë është në pikëpyetje sepse AKI-ja është në gjendje t'i suprimojë të gjitha institucionet e tjera, por normalisht dikush tjetër është mbi AKI-në, por të cilin do ta them pak më vonë", ka deklaruar Selmanaj. Megjithatë ka thënë se në raport nuk kanë dëshmi që pohojnë se urdhri është dhënë nga presidenti Hashim Thaçi, deputeti Selmanaj këtë përgjegjësi ia hodhi presidentit. Ai tha se gjatë intervistimit janë përballur me mospërputhje të deklaratave dhe dëshmi të rreme nga ish-shefi i Policisë së Kosovës, tash shef i AKI-së, Shpend Maxhuni, dhe ish-shefi i AKI-së, Driton Gashi, lidhur me atë se a ka qenë në dijeni për operacionin kreu i Policisë. Deputeti i PDK-së, Hajdar Beqa, ka thënë se janë të interesuar që ky rast të zbardhet, por pati kritika për raportin, të cilin e quajti jokredibil. Deputeti Beqa ka thënë se në shtëpi paku tri raste komisioni ka marrë dëshmi pa kuorum që, sipas tij, i zhvlehtëson provat sa të mos mund të përdoren në raport. "Komisioni në disa raste ka vepruar kundër nenit 16, të Ligjit për hetim parlamentar, publiciteti i mbledhjeve të komisionit, nuk ka zbatuar në mënyrën e duhur çështjen e seancave të mbyllura, të administrimit të provave dhe të ruajtjes së sekretit zyrtar. Publikimi i informatave dhe ecurisë së punës së komisionit, nga kryesuesi dhe anëtarët e komisionit, është bërë në

kundërshtim me Ligjin për hetim parlamentar", ka thënë Beqa, i cili i ka replikuar deputetit Driton Selmanaj, duke thënë se nuk ka asnjë dëshmi që e bën përgjegjës për urdhërdhënie presidentin Hashim Thaçi. "Në asnjë rast nuk kemi pasur që zotëri Thaçi apo një zyrtar i lartë ka dhënë urdhër", ka thënë Beqa. Për dëbimin e turqve, presidentin Thaçi përgjegjës e ka bërë edhe deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Glauk Konjufca. "Marrëdhëniet mes shtetit tonë dhe çdo shteti tjetër duhet të ndërtohen mbi parimet e reciprocitetit, të partneritetit strategjik, të interesave të përbashkëta dhe përfitimeve të dyanshme, kurse nëse e shohim se si ka ndodhur ky rast, atëherë mund të konkludojmë se pushtetarët tanë kanë vendosur një relacion të vasalitetit, mes Kosovës dhe një pushteti politik të një shteti tjetër. Kjo nuk duhet të ndodhë dhe kjo e dëmton Kosovën shumë", ka deklaruar Konjufca. Në emër të grupit parlamentar të AAK-së ka folur deputeti Muharrem Nitaj, i cili ka theksuar se pretendimet e deputetëve, se presidenti Hashim Thaçi është prapa këtij operacioni, janë vetëm qëndrime personale. "31 shkeljet që janë evidentuar në raportin që po votojmë sot janë argumentuar në komision një për një dhe janë tepër të qëndrueshme. Kush ka qenë i informuar për këtë operacion dhe kush e ka ditur apo kush ka qenë urdhërd-

hënës ose mbase gjithë kësaj është presidenti Hashim Thaçi ne nuk e dimë, por duhet ta pranojmë që të gjithë se komisioni hetimor nuk ka arritur ta argumentojë asnjë prej këtyre pretendimeve dhe deklaratat se kush është urdhërdhënës, ato janë observime individuale dhe s'janë pjesë të raportit", ka thënë deputeti Nitaj. Kurse deputeti Haxhi Shala në emër të Nismës Socialdemokrate ka pohuar se në Komision janë munduar ta bëjnë punën si duhet dhe të zbardhet dëbimi i gjashtë shtetasve turq. "Prokuroria e gjykata nuk janë të përfshira në këtë proces, këtë e vërteton edhe raporti. Ky raport as nuk konstaton dhe as nuk vërteton vlerësimin e AKI-së se personat në fjalë paraqesin rrezik për sigurinë", ka deklaruar ai, duke shtuar se Nisma e përkrah raportin në fjalë. Në mars të vitit të kaluar, me kërkesë të autoriteteve turke, autoritetet e Kosovës patën arrestuar dhe dëbuar për në Turqi gjashtë shtetas turq. Për gjashtë shtetasit turq, Ankara dyshon se janë anëtarë të organizatës "Hizmet", të udhëheqësit fetar turk Fetullah Gulen. Këtë të fundit autoritetet turke e fajësojnë për një përpjekje për grushtshtet në Turqi në vitin 2016. Më 28 qershor të vitit 2018 Kuvendi i Kosovës ka themeluar Komisionin Hetimor Parlamentar për ndriçimin e rastit të dëbimit nga Kosova të gjashtë shtetasve turq.

Haradinaj: Qeveria do t'u qëndrojë afër fermerëve

PRISHTINË, 24 QERSHOR (ER) - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur të hënën në takim një grup fermerësh nga Komuna e Ferizajt, të shoqëruar nga deputeti i kësaj zone në Kuvendin e Kosovës, Labinot Tahiri, me të cilët ka shqyrtuar modalitetet e kompensimit të dëmeve të shkaktuara nga breshëri në këtë anë.

Kryeministri Haradinaj ka thënë se kërkesat e tyre për kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga breshëri do të trajtohen në afat optimal. Ndër të tjera, kryeministri Haradinaj theksoi se qeveria e vendit do të ndër-marrë hapa konkretë për krijimin e një sistemi për kompensimin e dëmeve si një nismë e iniciuar në ekzekutiv vitin e

kaluar dhe që nuk është trajtuar asnjëherë më parë. "Qeveria e vendit, duke qenë përherë në mbështetje të fermerëve, do t'i shqyrtojë në afat optimal të gjitha mundësitë e trajtimit të kësaj teme në mënyrë që çështjet e ngritura nga ta të marrin kujdesin e merituar!", ka thënë kryeministri Haradinaj dhe ka vlerësuar se qeveria është duke punuar për krijimin e një fondi të përhershëm për kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe për aktivizimin e sistemeve mbrojtëse. Nga ana e tyre, fermerët falënderuan kryeministrin Haradinaj për gatishmërinë që t'i dëgjojë shqetësimet dhe kërkesat e tyre dhe kërkuan që ato të shqyrtohen sa më parë që është e mundur.



Kompania norvegjeze, e interesuar për investime në menaxhimin e mbeturinave

PRISHTINË, 24 QERSHOR (ER) - Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka pritur të hënën në takim Henrik Selstam, kryeshef ekzekutiv nga kompania "Scand Green Energy", i cili ishte i interesuar të investojë në Kosovë në sektorin e energjisë së ripërtrishme.

"Scand Green Energy" është kompani norvegjeze e cila ka më shumë se 30 vjet përvojë në prodhimin e kimikateve dhe ka fabrika në vende të ndryshme të botës si, Sllovakia, Danimarka dhe Gjermania.

Henrik Selstam, së bashku me delegacionin, vizituan ministrin Lluka me qëllim që të informohen rreth fushës së riciklimit të mbeturinave me qëllim të prodhimit të energjisë.

Kreu i MZHE-së, Valdrin Lluka, i ka informuar mysafirët rreth gjendjes së këtij sektori dhe për mundësitë e investimit në Kosovë, përkatësisht në këtë



fushë. "Sektori i riciklimit të mbeturinave është prej sektorëve që ka potencial shumë të madh, mirëpo ka më së

paku zhvillim në Kosovë. Qeveria e Kosovës është shumë e interesuar ta zhvillojë më tepër këtë fushë. Janë dy

mundësi që të investohet: e para është që investimi të jetë në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës, si aksionare krye-

sore me 51 për qind, e cila lehtëson përfitimin e granteve nga fondet IPA. Mundësia e dytë është që kompania e vetme të investojë përmes Ligjit për Investime Strategjike", ka thënë Lluka.

Henrik Selstam ka falënderuar ministrin për informacionet e dhëna, duke thënë se "Scand Green Energy" është duke shikuar të investojë rreth 65 milionë euro në Kosovë. "Ne jemi shumë të interesuar të investojmë në Kosovë për shkak të potencialit që ofron ky vend. Sipas studimeve preliminare që kemi bërë, parashihet që nga 50 deri në 65 milionë euro të investohen në Kosovë duke ndërtuar një termocentral për riciklimin e mbeturinave", ka deklaruar Selstam.

Kreu i MZHE-së ka falënderuar përfaqësuesit e kësaj kompanie që kanë zgjedhur Kosovën si vend të mundshëm për realizimin e këtij investimi dhe u ka ofruar përkrahje për realizimin e këtij projekti.

Mbahet sesioni informues në Zvicër me temën "Klima e investimeve në Kosovë"

PRISHTINË, 24 QERSHOR (ER) - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme, Ambasadën e Republikës së Kosovës në Vjenë dhe Rrjetin e Bizneseve të Diasporës Shqiptare në Zvicër, më 22 qershor 2019 në Bern të Zvicrës organizuan sesionin informues

"Klima e investimeve në Kosovë".

Në këtë sesion informues u njohuan bizneset pjesëmarrëse të diasporës shqiptare në Zvicër rreth shërbimeve të KIESA-s dhe informatave statistikore të shkëmbimit tregtar dhe investimeve Kosovë - Zvicër. Gjatë sesionit u bënë prezantime edhe nga përfaqësues të Administratës Tatimore, Agjencisë Kosovare të Privatizimit si dhe Agjencisë së

Ushqimit dhe Veterinarisë. Ndërsa Arbër Muhaxheri, drejtor i Drejtorisë për Promovim të Sektorit Privat në KIESA, para të pranishmëve prezantoi sektorët potencialë për investime në Kosovë.

Pas sesionit përfaqësuesit e KIESA-s kanë zhvilluar takimet me bizneset pjesëmarrëse, ku janë dhënë sqarime rreth fushave të cilave kanë shprehur interesim.



Telekomi shkëput kontratën me 'Z-Mobile'

Kontrata dhjetëvjeçare e Telekomit të Kosovës me kompaninë "Z-Mobile" do të shkëputet më 30 korrik. Kështu ka bërë me dije të hënën kryeshefi i Telekomit të Kosovës, Bedri Istrefi

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 24 QERSHOR - Bordi i Telekomit të Kosovës ka marrë vendim ta ndërpresë kontratën me kompaninë "Z-Mobile", duke konsideruar se kjo kontratë e nënshkruar dhjetë vjet më parë ka rezultuar të jetë e dëmshme për Telekomin dhe e ka futur në krizë financiare. Lajmin për shkëputjen e kontratës e ka bërë me dije të hënën kryeshefi ekzekutiv i Telekomit të Kosovës, Bedri Istrefi, gjatë një proteste të punëtorëve të

sindikates së kësaj kompanie. "Jemi ende duke diskutuar edhe në aspektin financiar. Kemi kontraktuar një kompani ndërkombëtare që të bëjë një analizë financiare, ku si raport preliminar ka dalë pozitiv sa i përket Telekomit, në të njëjtën kohë kemi pranuar edhe një njoftim zyrtar nga ekspertiza e jashtme ligjore ku na jep të drejtën që ne si Telekom ta njoftojmë operatorin 'Z-Mobile' për shkëputjen e kontratës nga data 30 korrik", ka thënë Istrefi.

Kryetari i Federatës Sindikale të Postë-Telekomit të Kosovës,

Lamih Balaj, ka thënë se punëtorët janë të bashkuar dhe të vendosur ta largojnë krimin e korrupsionin nga Telekom i Kosovës. "FSP-PTK bashkë me punëtorët janë të bashkuar si asnjëherë më parë që njëherë e përgjithmonë ta largojmë krimin dhe korrupsionin nga Telekom i Kosovës. Data 30 korrik 2019 është dita kur Telekom do të lirohet nga kontrata me 'Z-Mobile'", ka thënë Balaj.

Qindra punëtorë të Telekomit të Kosovës kanë dalë të hënën për të protestuar përpara objektit në lagjen "Dardania" kundër vazhdimit të kontratës me "Z-Mobile". Ata kanë mbajtur në duar disa pankarta me mbishkrimin: "Hienat jashtë Telekomit", "Vala e Kosovës e fiti-

mi i Z-Mobile", "Fol me zë, vjedh pa zë", si dhe "'Z-Mobile', korrupsion me pako pa limit".

Telekomi i Kosovës dhe kompania "Z-Mobile" në vazhdimësi kanë pasur mosmarrëveshje në lidhje me kontratën. Mospajtimet mes palëve kishin nisur kur "Z-Mobile" ka kërkuar numra shtesë.

Çështja kishte shkuar në Arbitrazh dhe më pas Gjykata e Prishtinës kishte vendosur në favor të kompanisë "Z-Mobile". Ndërkohë, për dëmin e shkaktuar, Telekom i obligohej t'i jepte numra shtesë "Z-Mobile", t'i ofronte shërbimet 3G dhe 4G dhe të paguante një gjobë rreth 26 milionë eurosh në emër të shpagimit të dëmit, fitimit të humbur dhe shpenzimeve të procedurës së arbitrazhit. Kompania "Z-Mobile" kishte

kërkuar që borxhi prej 26 milionë eurosh të paguhet, në të kundërtën do të fillohen procedurat e përmbarimit, që nënkupton mbylljen e llogarive bankare të Telekomit të Kosovës.

Qeveria fillimisht kishte shqyrtuar mundësitë financiare për ta paguar borxhin në mënyrë që ta shpëtonte Telekomin nga falimentimi, por që nuk e kishte bërë një gjë të tillë.

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, pati deklaruar se qeveria nuk do ta paguajë këtë borxh. Telekom i Kosovës është kompani publike e transformuar në shoqëri aksionare, në të cilën operon telefonia fikse dhe ajo mobile Vala.

Operatori Vala ka mbi 1.2 milion konsumatorë në nivel vendi. Kjo kompani ka përafërsisht 2 400 punonjës, kurse paga mesatare llogaritet të jetë mbi 730 euro.



Produktet 'Made in Kosova' synojnë tregun amerikan

PRISHTINË, 24 QERSHOR (ER) - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), së bashku me kompani nga Kosova, po marrin pjesë në panairin "Fancy Food Show" në Nju Jork, i cili po mbahet nga data 23 deri më 25 qershor.

Në këtë panair, krahas mbi 2 600 kompanive ndërkombëtare, produktet e tyre po i

promovojnë edhe kompanitë nga Kosova falë mbështetjes dhe organizimit nga MTI/KIESA.

Kompanitë kosovare përmes kontakteve direkte dhe takimeve me ndërmarrës nga ShBA-ja dhe vendet e ndryshme të botës synojnë depërtimin e produkteve të tyre, me theks të veçantë rritjen e eksportit dhe të ndikojnë në zhvillimin ekonomik të vendit

tonë.

Ky panair është një mundësi e mirë për kompanitë kosovare të njihen për së afërmi me trendet e industrisë ndërkombëtare dhe të lidhin marrëveshje eksporti në të ardhmen. Standi i Kosovës po vizitohet nga blerës, distributorë dhe agentë shitjesh nga shtete të ndryshme të botës të cilët po njoftohen me produktet dhe mundësitë që ofron Kosova për të bërë biznes.



Kthehet në rigjykim rasti i Pjetër Ndrecajt, i dënuar me burgim të përjetshëm

PRISHTINË, 24 QERSHOR (ER) - Gjykata Supreme e Kosovës ka vendosur ta kthejë në rigjykim rastin e Pjetër Ndrecajt, i cili është dënuar me burgim të përjetshëm për shkak të vrasjes së gruas dhe vajzës së tij. "Kolegji i Gjykatës Supreme, në çështjen penale kundër të akuzuarit P. N. nga Gjakova, për shkak të veprës penale vrasje e rëndë dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim të paautorizuar të armëve, duke vendosur përkritazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuar, paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës

Themelore në Gjakovë, të datës 19 nëntor 2018 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit, të datës 31 janar 2019, në seancën e kolegjit, të mbajtur më 16 maj 2019, ka aprovuar ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit P. N. dhe ka anuluar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë dhe aktgjykimin e Gjykatës së Apelit dhe çështjen ia ka kthyer Gjykatës së Shkallës së Parë në rivendosje. Ndaj të akuzuarit P. N. është vazhduar paraburgimi", është thënë në njoftimin e Gjykatës Supreme të Kosovës. Sipas këtij njoftimi, Kolegji i



Gjykatës Supreme ka gjetur se aktgjyqimi i shkallës së parë është i përfshirë me shkelje

esenciale të dispozitave të procedurës penale. "Me kthimin e çështjes në rivendosje, sipas

Gjykatës Supreme, Gjykata e Shkallës së Parë, në aspektin formal, duhet të nisë nga shqyrtimi fillestar, mirëpo të mos e pranojë fajësinë në rrethana të një deklarimi të ngjashëm nga ana e të akuzuarit në raport me vrasjen e vajzës së tij, por çështja të kalojë në shqyrtim gjyqësor, për t'i sqaruar rrethanat e vrasjes në aspektin subjektiv-forma e fajit, e pastaj të marrë një vendim të drejtë dhe të ligjshëm në këtë çështje penalo-juridike", është theksuar në njoftimin e Gjykatës Supreme të Kosovës.

Komuna e Mitrovicës ka shënuar rritje në inkasimin e të hyrave



MITROVICË, 24 QERSHOR (ER) - Të hënën është mbajtur mbledhja e radhës e Bordit të Drejtorëve të Komunës së Mitrovicës e cila është drejtuar nga nënkryetari Faruk Mujka. Në këtë mbledhje auditori komunal, Nexhat Barani, ka njoftuar ekzekutivin

lidhur me planin e veprimit për implementimin e rekomandimeve nga raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitet 2017 dhe 2018. Auditori Barani ka theksuar se ky plan do të hartohet së bashku me kryetarin si dhe drejtoritë komunale të

Mitrovicës.

Ndërsa drejtori i Financave, Shukri Gashi, gjatës kësaj mbledhje ka shpalosur inkasimin e të hyrave vetjake për periudhën janar-maj të këtij viti. "Komuna e Mitrovicës për periudhën raportuese janar-

maj 2019 ka arritur të inkasojë të hyra vetjake në vlerë 1030056.33 euro apo 100.31 për qind të planifikimit për këtë periudhë, ndërsa në krahasim me periudhën e njëjtë raportuese të vitit paraprak, komuna ka shënuar rritje në

inkasimin e të hyrave në shumën prej 225455.34 eurosh apo 28.02 për qind", ka thënë drejtori Gashi. Ai ka bërë me dije se Drejtoria e Urbanizmit si dhe Drejtoria e Bujqësisë kanë arritur ta sigurojnë përqindjen më të madhe sa i përket inkasimit të të hyrave vetjake për këtë periudhë raportuese.

Ndërsa krahasuar në vlera, Drejtoria e Urbanizmit dhe Drejtoria e Financave dhe Zhvillimit Ekonomik kanë arritur t'i inkasojnë vlerat më të mëdha, ku Drejtoria e Urbanizmit merr pjesë me 33.59 për qind, ndërsa Drejtoria e Financave me 33.40 për qind në totalin e inkasuar. Në anën tjetër, Hysni Ahmeti, drejtor i Inspeksionit, ka theksuar se në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, më 21. 06. 2019 ka inspektuar lokalet që shkaktojnë zhurmë në orët e vona të mbrëmjes. Drejtori Ahmeti ka thënë se pronarët e lokaleve duhet t'i kenë parasysh ligjet dhe rregulloret në fuqi në mënyrë që të mos detyrohemi t'u shqiptojmë gjoba që do t'i dëmtonin bizneset e tyre.

Të burgosurit punuan rreth 100 karrige dhe tavolina

MITROVICË, 24 QERSHOR (ER) - Në vazhden e aktiviteteve të punës së organizuar nëpër burgje, të burgosurit e Qendrës së Paraburgimit në Mitrovicë kanë punuar rreth njëqind karrige dhe tavolina. "Qëllimi i punës së organizuar në burg është mbajtja dhe zhvillimi i aftësisë profesionale dhe kapacitetit të punës së të burgosurit. Kjo përmirëson mundësitë e të bur-

gosurit për të jetuar edhe pas lirim. Përveç kësaj, puna normalizon jetën e përditshme në burg", është thënë në njoftimin e Shërbimit Korrektues të Kosovës (ShKK). Secili punim i kryer nga të burgosurit në punëtoritë e ShKK-së kryesisht përdoret për nevojat e qendrave korrektuese dhe atyre të paraburgimit. Disa prej tyre jepen edhe donacion.



PROVOKIMI, ARMË E MENDJEVE INFERIORE



Nusret PLLANA

Inteligenca e kulluar e njeriut nuk e njeh formën provokuese si një mënyrë të marrëdhënieve në shoqëri, përkundrazi, jo vetëm që nuk e ushqen, por e lufton dhe e dënon atë si një reaktiv inferior. Provokimi politik është armë e mendjeve inferiore që përdoret për ta nxitur apo përshkallëzuar konfliktin mes "palëve". Ajo është arma e preferuar e diktatorëve ose diktaturave për të bërë trysni mbi kundërshtarin, nganjëherë shërben edhe për ta trimëruar veten në situata paniku. Provokimi politik nuk është komponent i formimit estetik sepse, në thelb, estetika është nëna e etikës, funksioni i së cilës është ta ngrejë cilësinë e komunikimit të individit në nivelet më të larta, duke mos e lënë të bjerë në banalitete dhe veprime të ulëta për qëllime mesquine, anakronike, diabolike që prishin ekuilibrat brenda një shoqërie, aq më tepër kur këta ekuilibra janë tejte të brishtë, siç është rasti i shoqërisë sonë që kërkon të krijojë një vetësiguri dhe mbijetesë. Gjithë këto ditë kam ndjekur me vëmendje provokimet e një qeverie dhe një kryeministri në panik. Qetësia e shtirë dhe batutat e dala boje, padisin shformimin e amalgamës së një klani aventurier që është duke u vetëgremisur. Arrestimet poli-

tike janë forma më evidente e degradimit të një qeverie diktatoriale, e cila mund të arrestojë, të godasë, të helmojë dhe të shtypë përkohësisht me mjetet e dhunshme masat, por kurrë nuk mund të fitojë mbi lirinë! Çdo njeri që ka lexuar historitë e diktaturave, e di mirë çfarë është dallja e lirisë: fundin e turpshëm të diktatorëve, mbase dhe të tmerrshëm. Një filozof (!) thotë: "Populli që rrihet pret të ngre krye"! Këtë thënie pothuajse e ka harruar klasa e politikës shqiptare, veçanërisht "Rilindja" e Ramës.

Pjesë e turpshme e provokimit politik u bë e ashtuquajtura "Opozita e Re", teprica listërore që mbiu në Parlament nga fara e "Rilindjes", e që po i shërben Ramës si helm për t'i ruajtur kokën. Ky formacion pa identitet, i përbërë nga individë që hiqen si të zgjedhurit e popullit dhe flasin në emër të elektoratit, megjithëse propocionalë në lista pa ballafaqim e personalitet hipotekalpolitik, është një tjetër dëshmi e disfunkcionit të demokracisë tek ne, që tregon se sa serioze dhe emergjente është situata politike në vendin tonë. Përveç dy anëtarëve të listës emërore të Opozitës së Re, asnjë tjetër nuk ka fuqi për të kandiduar pa siglën e Partisë Demokratike apo të LSI... Të gjendur aksidentalisht në Parlament, në karriget e rreshtuara në krahun e opozitës, ata flasin për një moral opozitar që, përveçse nuk është opozitar, nuk është as fare moral por, thjesht, një prostitucion politik, që ka për qëllim të krijojë një imazh "normaliteti" të ligjvënës, aq më tepër sot kur kauza e opozitarizmit është kryeçështja e ditës në Shqipëri.

Dublimi i opozitës është gjithashtu akti më i shëmtuar politik që pas shembjes së diktaturës në Shqipëri. Asnjë ish-kryeministër nuk e ka tentuar e, ndoshta, as që e ka çuar ndërmend këtë skenar. Ky lloj "legjitimiteti" i një parlamenti ilegjitim, që ka humbur çdo lloj sensi logjik para një opinioni të shëndoshë, është shndërruar në një grotesk që ngjall njëherazi gaz dhe trishtim! Vallë kjo është elita e ndërgegjes së nacionit?! Jo! Atëherë pse jemi katandisur në këtë gjendje? Epo... Shqipëri hesapi. Në Kuvend mund të shkojë gjithkush! Në traditën tonë etnike, në Kuvend shkonin vërtet të gjithë, por protagonist nuk mund të ishte gjithkush. Flisnin të urtët, trimat dhe të tjerët dëgjonin dhe bindeshin. Vendosej për të mirën e përgjithshme dhe zbatohesh me vullnet nga të gjithë. Parlamenti aktual është i atillë si rezultat i devijimit nga demokracia. Sepse demokracia e vërtetë nuk definohet nga numrat. Po të ishte për numrat atëherë rekordi iu përket diktaturave. Rasti i provokimit të presidentit të Republikës për shkarkim është tjetër dëshmi se rendi kushtetues në Shqipëri ka rënë. Vendi ka shkuar nga republika parlamentare drejt asaj kryeministore të tipit musolinian. Të gjitha institucionet ligjzbatuese në vend, që nga policia e deri te Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, po iu binden verbërisht urdhrave të kryeministrit, edhe pse e dinë se veprimi i tyre është shkelje flagrante e ligjit, ndërkohë që në kushtet e mungesës së Gjykatës Kushtetuese çdo sulm ndaj institucionit të presidentit s'është tjetër veçse grusht shteti. Vetëm kjo Gjykatë ka të drejtë t'i

shqyrtojë vendimet e Presidentit gjatë ushtrimit të kompetencave të tij. Aventurierët rozë vazhdojnë revanshin... nuk ndalen, duke matur pulsën opozitar me instrumentin kriminal të provokimit, për të parë se sa duron opozita? Tani Ramëzinjtë po përgatiten që të nxjerrin një "ligj" të ri puro komunist, sipas të cilit, njerëzve që protestojnë kundër Komisioneve zgjedhore t'u ndalohet dalja jashtë atdheut për 5 deri 10 vjet. Ky është budallallëku dhe çmenduria më e madhe që mund të kem dëgjuar ndonjëherë. Shkelje flagrante e të drejtave të njeriut!!! Arrestimi i më se 190 protestuesve të opozitës, kërcënimi i Bashës me pislëqet e teneqexhiut, arrestimi i ish-deputetit Bardh Spahia, provokon opozitën për t'u rënë trumbetave deri në skajin e fundit..., që pastaj klani socialist të shfajësohet në arenën ndërkombëtare: "E shikoni, nuk ishte faji ynë...!!!". Në Shkodrën dhe Kavajën e demokracisë po zhvillohen përleshje midis protestuesve e policisë politike, gjithashtu dhe në qytete të tjera si Tropojë, Kukës etj. Në Shkodër, kryetarja e Bashkisë nuk i dha leje Edi Ramës për ta zhvilluar mitingun në një nga sheshet kryesore të qytetit. Ai e zhvilloi me dhunë (rreth një mijë forca policie ishin bërë kordon për t'i bllokuar protestuesit) duke thyer ligjin. Ligjin duhet ta zbatojnë të tjerët, por ai jo?! Provokim i hapur për gjakderdhje! Voltana Azemi, kryetare Bashkie, autoritetplot, një zonjë e nderuar që vjen nga një familje e persekutuar, e cila u shqua që më 2 prill 1991, si një trimëshë antikomuniste, tani

ajo hahet dhëmb për dhëmb me Ramëziun, një laraman në shpirt dhe në psikë. Rama, që deri dje mburrej për mjeshtërinë e tij në artin e provokimit, tashmë duket se ka dalë fare jashtë kontrollit. I provokuar nga kriza që ka shkakuar vetë, ai përpiqet të kapet pas imazhit të mbështetjes perëndimore duke shfrytëzuar për këtë deri dhe agjendën e rutinës diplomatike. Mos mendon ai se ka në krah Perëndimin dhe duhet t'i hipë në shpinë opozitës?! Një gjë nuk e di ai dhe diletantët politikanë dhe nuk e kuptuan kurrë, se Perëndimi, bën rokadën sipas situatave, bile, kur mendon se i ke fituar dhe i ke miq... papritmas i humbet, sepse ata i kanë të shenjta parimet e lirisë dhe nuk i shkelin kurrë.

Provokimi politik është lojë e mendjeve inferiore që moleps rangun më të ulët të shoqërisë civile, politike dhe ushtarake, të cilët nuk janë kurrë në gjendje të ngrihen në nivelin e lidërshipt intelektual bashkëkohor, për t'i shërbyer filozofisë së bashkëpunimit, zhvillimit, stabilitetit dhe qeverisjes së një shteti sipas parimeve dhe standardeve të demokracisë së vërtetë. Prandaj Shqipëria zvarritet në agoni, duke kaluar nga ekstremi në ekstrem. Shqiptarët do t'i gëzojnë frytet e lirisë vetëm atëherë kur pushtetarët e tyre të kuptojnë se respekti për kundërshtarin politik është një nga vlerat më të larta që kultivon demokracia. Këtë virtyt e gëzojnë natyrisht vetëm liderët e emancipuar, por jo provokatorët e konflikteve politike, që synojnë ta zgjasin pushtetin nëpërmjet zgjatjes dhe thellimit të krizës politike e cila i ka zënë frymën mbarë shoqërisë sonë.

Në Komunën e Rahovecit ka filluar regjistrimi i nxënësve në klasat e dhjeta

RAHOVEC, 24 QERSHOR (ER) - Në Komunën e Rahovecit nga e hëna ka filluar regjistrimi i nxënësve në shkollat e mesme, në klasat e dhjeta, në tri gjimnaze "12 Maji", në fshatin Ratkoc, "Ukshin Hoti" në fshatin Krushë e Madhe dhe në Shkollën e Mesme

Profesionale "Selajdin Mullabazi-Mici". Afati për paraqitjen e dokumenteve dhe shpalljen e rezultateve për gjimnaze dhe shkollën profesionale për vitin shkollor 2019/2020 bëhet më 24, 25 dhe 26 qershor 2019 në lokalet e shkollës amë, ku nxënësit

dëshirojnë të regjistrohen, duke filluar nga ora 8:00 deri në orën 16:00. Sipas planifikimeve të tri shkollave të mesme dhe një shkolle të mesme profesionale, në klasat e dhjeta planifikohen të regjistrohen mbi 937 nxënës të ndarë në 31 paralele.



Vishu me stil si Kim Kardashian



Ylli i famshëm televiziv, Kim Kardashian, njihet si ikonë e modës. Ajo çdoherë duket seksi në rrobat e saj. Sipas "Hollywood Life", Kimi shkëlqen


edhe kur ka të veshur veshje sportive, pasi ajo ato i kombinon me rroba të bukura. Stili i saj, sipas ekspertëve të modës, ka evoluar ndër vite në aspekt pozitiv.

Vajza e Madonnës, bukuroshe si e ëma



Vajza e këngëtares së njohur, Madonna, Lourdes Leon, është shumë e bukur. Leon u fotografua nga paparacët teksa shëtitej rrugëve të Nju Jorkut.

22-vjeçarja ka një stil interesant dhe të veçantë si të nënës. Në fotografitë e fundit të publikuara në internet, ajo ka veshje sportive që i rrinë shumë bukur.



Rekordi i ri historik i Dua Lipës

Dua Lipa ka vendosur një tjetër rekord në muzikë. Këngëtarja 23-vjeçare me origjinë shqiptare është e para femër në histori që ka tri këngë që janë dëgjuar mbi 800 milionë herë në Spotify. Dua e ka arritur këtë rekord me këngët "New Rules", "One Kiss" dhe "IDGAF". Dua

Lipa nuk ka publikuar një këngë të re prej muajsh, por më herët ka njoftuar fansat se është duke punuar për albumin e ri dhe shumë shpejt do t'i publikojë projektet e reja. Në muajin shkurt, Dua u bë e para shqiptare që fitoi dy çmime Grammy, ngjarja më e rëndësishme muzikore në ShBA.

Rikthehet Rolling Stones



The Rolling Stones është kthyer. Grupi u kthye javën që lamë pas në një koncert në Çikago, duke filluar kështu turneun për herë të parë pas operacionit në zemër të Mick Jaggerit. Rolling Stones njoftoi

se po e shtyn turneun në mars, disa ditë para se Mick të vendoste një stent në zemër gjatë një operacioni në Nju Jork. Grupi do t'i vazhdojë koncertet në Amerikën e Veriut gjatë verës.

E rrallë

Në Kinë nis festivali ku gatohen qentë

Rreth 1.5 milion njerëz kanë firmosur peticionin kundër festivalit në Julin të Kinës, ku 10 000 deri në 15 000 qen konsumohen si ushqim. Përveç mizorisë me të cilën trajtohen kafshët, para dhe gjatë therjes, shumë prej tyre janë vjedhur nga të zotët, pasi në zona të tjera të Kinës qentë nuk konsumohen për ushqim. Fushatën për ta ndaluar këtë mizori e kanë mbështetur jo vetëm miliona njerëz



nga Kina dhe nga e gjithë bota, por edhe aktorë të famshëm e persona me ndikim.

FOTO E DITES



Një peshkatar shihet pranë lumit Taedong në Phenian, i cili është i mbuluar nga algat. / Fotografia nga Ed Jones - AFP.

E jashtëzakonshme

Ura me fije bari

Çdo vit ura e fundit e Inkasve, e bërë prej bari, hidhet në tokë dhe thuret nga e para për t'u përdorur mbi lumin Apurimak, në rajonin Kusko të Perusë. Ura Kuesaçaka thuret me dorë dhe ka funksionuar kështu për të paktën 600 vjet. Dikur ka qenë pjesë e një rrjeti jetik që lidhte qytetet më të mëdhenj të perandorisë Inkase dhe u shpall trashëgimi botërore nga UNESCO në vitin 2013.



BARSOLETA E DITËS



Gruaja e shokut:

- Mbrëmë takova rastësisht gruan tënde dhe i tregova një barsoletë, i tha Gimi shokut të vet.
- Dhe...?
- Ajo qeshi aq shumë sa, gati, nuk ra nga krevati!



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Ne ora 16:00 (vikendit ne ora 14:00 dhe 16:00)
“THE SECRET LIFE OF PETS 2” 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 26 min
Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Harrison Ford, Patton Oswalt, Eric Stonestreet, Jenny Slate, Lake Bell, Hannibal Buress, Nick Kroll, Dana Carvey, Ellie Kemper, Pete Holmes, Garth Jennings, Bobby Moynihan
Regjia: Chris Renaud and Jonathan Del Val



Ne ora 18:00
“X-Men; Dark Phoenix”

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 53 min

Rolet: James McAvoy, Michael Fassbender, Jennifer Lawrence, Nicholas Hoult, Sophie Turner, Tye Sheridan, Alexandra Shipp, Kodi Smit-McPhee, Evan Peters, and Jessica Chastain
Regjia: Simon Kinberg

Në ora 20:00

“MEN IN BLACK; INTERNATIONAL” 3D,

Aksion/Komedi/Sci-Fi; 1 orë 55 min

Rolet: Chris Hemsworth, Tessa Thompson, Kumail Nanjiani, Rebecca Ferguson, Rafe Spall, Laurent Bourgeois, Larry Bourgeois, Emma Thompson, Liam Neeson
Regjia: F. Gary Gray



Ne ora 22:00

“M A”

Horror/Triller; 1 ore 39 min

Rolet: Octavia Spencer, Juliette Lewis, Diana Silvers, Luke Evans, McKaley Miller, Missi Pyle, Corey Fogelmanis, Gianni Paolo, Dante Brown

Regjia: Tate Taylor



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.




DASHI

Situata tensioni që ju nuk i menaxhoni dot do ta nxjerrin në pah shpirtin organizativ të partnerit. Do të jetë ai personi që do të ndreqë çdo gjë.



DEMI

Sot jeni shumë në humor dhe, më në fund, edhe partneri nuk vuan nga xhelozitë tuaja të kota. Dita paraqitet e qetë dhe në harmoni.



BINJAKËT

Edhe pse keni marrë shumë premtime, dita e sotme do të vërtetojë që jo të gjithë do të qëndrojnë korrektë me atë që ju kanë thënë.



GAFORRJA

Sot do të flisni për financa dhe për biznes që në orët e para të ditës. Nëse janë veç fjalë dhe nuk do të kaloni në veprime konkrete, nuk presin punët.



LUANI

Do të ketë ndryshime të mëdha në jetën tuaj që nuk i keni më parë. Do të viheni përballë një zgjedhjeje të vështirë.



VIRGJËRESHA

Sot jeni të gatshëm të qartësoni disa çaste të së shkuarës tuaj si dhe t'i rregulloni marrëdhëniet me pjesëtarët e familjes.



PESHORJA

Një mik do t'ju zhgënjejë sot në qëndrimin që do të mbajë lidhur me një çështje të përbashkët. Do të mësoheni se si t'i zgjidhni më mirë miqtë.



AKREPI

Nuk doni të jeni shumë popullor sot dhe mjaft vendime tuaja do të kundërshtohen. Gjithsesi do të dini të argumentoni çdo gjë që keni bërë.



SHIGJETARI

Nëse keni lënë gjëra pezull dhe pa zgjidhur, sot duhet të filloni të programoni se sa kohë do t'i kushtoni secilës prej tyre.



BRICJAPI

Nuk keni ndihmën e yjeve sot dhe në çdo hap duhet të sforcoheni dyfish për të zgjidhur punë. Gjithsesi ju jeni mësuar me pengesa kohët e fundit.



UJORI

Një miqësi e hershme ka shumë gjasa të kthehet në një marrëdhënie pasionante. Të dy po përpigjeni ta shmangni këtë gjë.



PESHQIT

Deri në mesditë do t'i keni mbyllur të gjitha çështjet e rëndësishme që kishit lënë për sot. Më pas gjithçka është në dorën tuaj për zbatimje.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

Feronikeli synon me fitore të debutojë në Ligën e Kampionëve

Kastriot Rexha është gati të "bombardojë" portën e kundërshtarëve në Ligën e Kampionëve, Lincoln Red Imps. Sulmuesi shtatlartë pret fitore në këtë ndeshje shumë të rëndësishme për skuadrën nga Drenasi. "Detyra e çdo sulmuesi është shënimi i golave. Do të angazhohem maksimalisht dhe shpresoj të shënoj në ndeshjen time të parë në Evropë, por dëshira më e madhe është që skuadra të fitoj", ka thënë Rexha



Zekrija Ramadani nuk kanë aspak frikë. "E njohim kundërshtarin dhe mund të them se ka një përvojë të madhe dhe ne kemi respekt për këtë skuadër, por jo frikë. Kemi futbollistë të dëshmuar dhe me përvojë në skuadër që mund t'u bëjnë ballë pa ndonjë problem kundër-

shtarëve në këtë nivel", ka deklaruar ai. "Detyra e çdo sulmuesi është shënimi i golave. Do të angazhohem maksimalisht dhe shpresoj të shënoj në ndeshjen time të parë në Evropë, por dëshira më e madhe është që skuadra të fitoj", ka thënë Rexha. Ndërsa skuadra e Feronikelit nëpërmjet një njoftimi për medie ka kërkuar mirëkuptimin e qytetarëve që jetojnë afër stadiumit "Fadil Vokrri" dhe të mos parkojnë veturat rreth stadiumit për faktin se ndeshja ka një rëndësi të madhe dhe numri i shikuesve pritet të jetë i madh. Sot (e martë) në stadiumin "Fadil Vokrri" nga ora 15:00 zhvillohet edhe ndeshja tjetër në mes Tre Penne dhe FC Santa Coloma. Fituesit e këtyre dy ndeshjeve do të përballen ndërmjet vete në finale.

EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 24 QERSHOR - Kampioni dhe fituesi i Kupës së Kosovës në Futboll për edicionin 2018/2019, Feronikeli, po synon që të debutojë me fitore në garat e Ligës së Kampionëve. Në fakt, skuadra nga Drenasi sonte (e martë) do të luajë ndaj Lincoln Red Impsit në stadiumin "Fadil Vokrri" nga ora 20:45 në kuadër të rrethit preliminar në Ligën e Kampionëve. Kastriot Rexha ka thënë për "Epokën e re" se synim i kampi-

onëve të Kosovës është prezantimi sa më i mirë i futbollit të Kosovës në arenën ndërkombëtare dhe normalisht edhe rezultati pozitiv. Sulmuesi kryesor në futbollin e Kosovës është shumë i lumtur se ndeshja do të zhvillohet në stadiumin "Fadil Vokrri". "Jemi mirë të përgatitur maksimalisht për të debutuar në arenën ndërkombëtare, pasi për mua personalisht dhe skuadrën e Feronikelit është ndeshja e parë në Evropë. Pas sukseseve në rrafshin vendor është koha që 'Nikli' ta prezantojë në mënyrë se më të

mirë futbollin tonë dhe normalisht se duam edhe fitore. Jam shumë i lumtur se ndeshja zhvillohet në Prishtinë dhe se tifozët mund të jenë nga afër për ta përçjellë këtë ndeshje të rëndësishme dhe për të na mbështetur siç dinë ata", ka thënë Rexha, i cili është ndër më meritoret për suksesin e dyfishtë të Feronikelit në edicionin e fundit. Sulmuesi shtatlartë ka folur edhe për skuadrën kundërshtarë, duke e vlerësuar maksimalisht, në kohë të njëjtë duke konfirmuar se djelmohat e drejtuar nga trajneri

Loriana, e bronzë në 'Minsk 2019'



PRISHTINË, 24 QERSHOR - Kosova e ka fituar edhe medaljen e tretë në Lojërat Evropiane "Minsk 2019" dhe ndër më meritoret për këto suksese pa dyshim se është trajneri Driton Kuka. Pas Majlinda Kelmendit që e fitoi medaljen e artë dhe Nora Gjakovës që e fitoi të argjendtën,

Lorina Kuka të hënën ia ka siguruar medaljen e tretë Kosovës, pasi e ka fituar medaljen e bronzë. Xhuditja 22-vjeçare nga Peja e mposhti gjermanen Luise Malsahn përmes repe-sazhit në kategorinë -57 kg. Pas triumfit të Loriana Kukës ka reaguar edhe trajneri Driton

Kuka, i cili në "Facebook" ka shkruar: "Ndjenja e veçantë, kjo medalje kësaj radhe për familjen tonë si satisfaksion moral i dashurisë sonë për sportin. Për vëllanë tim, Sylën, njëherësh trajnerin tim. Loriana Kuka, 78 kg, medalja e tretë për Kosovën. Kosova mbi të gjitha".

Stavileci largohet nga Prishtina me 56 trofe

Blerand Stavileci të hënën e ka zyrtarizuar largimin nga KB Prishtina. Ai ka dhënë dorëheqje nga pozita e kryetarit, kurse ka thënë se po largohet me kokën lart, për faktin se klubi kryeqytetas nën udhëheqjen e tij ka fituar 56 trofe

PRISHTINË, 24 QERSHOR (ER) - Blerand Stavileci nuk do të jetë më kryetar i KB Prishtina pasi ka dhënë të hënën dorëheqje nga posti i kryetarit për shkak të ligjit të ri për parandalimin e konfliktit të interesit. "Ju pafsha gjithmonë kështu, të buzëqeshur e të lumtur me fitoret dhe sukseset e klubit tonë të zemrës, por ne kemi obligim ta respektojmë Ligjin si qytetarë të ndershëm e të

përgjegjshëm të vendit tonë. I njëjti ligj që dikur ma mundësonte mbajtjen e pozitës së kryetarit të klubit, sot ma pamundëson si rezultat i ndryshimeve që kanë pësuar dispozitat ligjore. Prandaj, sot, ofrova dorëheqjen nga ky post, me keqardhje të madhe e krenari të jashtëzakonshme njëkohësisht. Jam i bindur që Prishtina jonë do të vazhdojë edhe më fuqishëm dhe më suk-



sesshëm!", ka shkruar Stavileci në "Facebook". Stavileci ndihet krenar se nga klubi i zemrës largohet me plot 56 trofe të fituara. "Nuk qenka aspak e lehtë t'ju drejtohem në këtë

mënyrë sepse deri më tani pothuajse gjithmonë ju jam drejtuar për t'ju komunikuar lajme të mira dhe vendime të mëdha strategjike lidhur me të ardhmen e klubit tonë për të cilin kemi inves-

tuar shumë. Klubi im dhe i juaji i zemrës në gjithë këto vite është bërë një brend i njohur dhe i respektuar ndërkombëtarisht, duke na bërë krenarë si në Kosovë po ashtu dhe në Evropë. Jemi bërë sinonim i fitoreve dhe sukseseve. Vetëm në këta gjashtë vjetët e fundit ne kemi arritur të fitojmë plot 56 trofe. Vlera e tyre ishte po aq e madhe sa edhe ndjenja e të bërit krenarë me mijëra e mijëra shqiptarë anekënd botës", ka shtuar ai. Në fund Stavileci është i bindur se klubi kryeqytetas do ta vazhdojë rrugëtimin e suksesit, kurse ka premtuar se gjithmonë do të jetë përkrahësi më i madh i Prishtinës.

Krasniqi: Opozita s'ka kurajë t'i ndihmojë sportistët e artistët

PRISHTINË, 24 QERSHOR - Shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Memli Krasniqi, ka deklaruar sot se tema e amendamentimit të Ligjit për Sponsorizime, me të cilin

ndihmohen sportistët dhe artistët kosovarë, është urgjente. Këto komente Krasniqi i ka bërë para deputetëve të Kuvendit të Kosovës, në seancën për gjenetistët. Memli

Krasniqi ka akuzuar LDK-në dhe VV-në, të cilat nuk kanë pranuar ta votojnë këtë amendament, duke thënë se opozita mendon se është keq të mbështeten sportistët dhe

artistët. "Kjo është temë 100 herë më urgjente sepse lidhet me dhjetëra mijëra sportistë e artistë të Kosovës që i kanë sytë kah ky Kuvend. Ju që e keni thirrur këtë

seancë, nuk keni kurajën t'u dilni në ndihmë atyre, ashtu siç po ju dalim ne si koalicion qeverisës dhe ta jepni votën në favor të tyre", ka thënë Krasniqi.

Emini dhe Jashari largohen nga Ballkani

SUHAREKË, 24 QERSHOR - Mesfushori Leart Emini nuk do të jetë pjesë e skuadrës së Ballkanit në edicionin 2019/2020. Lajmin e ka konfirmuar vetë futbollisti Emini nëpërmjet një postimi në "Facebook". "Nuk do të jam më pjesë e FC Ballkanit. Falënderoj të gjithë ata që

sadopak me përkrahen gjatë këtij viti", ka shkruar Emini, i cili ka luajtur edhe për Besën, Llapin dhe Hajvalinë. Pas mesfushorit në fjalë nga skuadra e Ballkanit është larguar edhe mbrojtësi Dardan Jashari. Ky i fundit ka luajtur për skuadrën nga Suhareka në gjashtë

muajt e fundit. "Pas një gjysmedicioni të FC Ballkani, më nuk do të jem pjesë e këtij klubi. Falënderoj kryesinë e klubit, shtabin teknik, futbollistët dhe tifozët e FC Ballkanit për bashkëpunimin që patëm. Ju uroj suksese të mëtutjeshme", ka thënë Jashari.



Verë e nxehtë për basketbollin e Kosovës

PRISHTINË, 24 QERSHOR - Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) gjatë kësaj vere do të ketë shumë aktivitete. Përfaqësuesja 3X3, Kosova A te meshkujt, si dhe Kosova U-20, U-18, U-16, në konkurrencën e meshkujve dhe të femrave do të marrin pjesë në gara të rëndësishme ndërkombëtare. Në lidhje me të gjitha këto aktivitete në konferencë për medie kanë folur sekretarja e përgjithshme e FBK-së, Elvira Dushku dhe drejtori i përfaqësuesve, Granit Rugova. "Aktivitetet do t'i hapim me pjesëmarrjen e Kosovës në 3X3, ku është hera e parë që marrim pjesë në garat e FIBA-s në gara të tilla. Pas kësaj fillon Kampi Nacional nga 7 deri më 20 korrik në Suharekë, ku kampi do të ndahet në dy pjesë, vajzat U-13 dhe U-14, e më pastaj djemtë U-13 dhe U-14. Synimi është t'i nxjerrim talentet e së ardhmes. Më pas kemi gjashtë përfaqësues që do të marrin pjesë në Kampionate Evropiane, Divizioni B, duke nisur me U-18 femrat dhe duke e mbyllur me U-16 femrat. Një nga ngjarjet kryesore gjatë kësaj vere do të jetë organizimi i Kampionatit Evropian U-20 te femrat, Divizioni B. Ky kampionat organizohet në Prishtinë, nga 3 deri më 11 gusht, ku marrin pjesë 12 shtete. Ky është hapi i parë për ta nderuar Përfaqësuesen A të Kosovës në konkurrencën e femrave, ku synojmë të marrim pjesë në kualifikimet për Kampionatin



Evropian të shteteve të vogla", ka thënë Dushku. "Sa i përket organizimit, ne jemi duke bashkëpunuar me Ministrinë e Sportit që na ka ndihmuar jashtë mase, pastaj me Komunën e Prishtinës dhe FIBA-n. Punimet në palestrën '1 Tetori' po shkojnë shumë mirë, kurse edhe Pallati i Rinisë dhe Sportit do të jetë i gatshëm me disa intervenime të vogla. Kemi marrë përvojë nga organizimi i Kampionatit Evropian, Divizioni C, në Prishtinë, por për Divizionin B, kërkohen kritere më të larta. Kurse sa iu përket përgatitjeve për ndeshjet e Kosovës A në Mitrovicë më 7 dhe 14 gusht, aty paksa çalojmë, sepse aty kërkohen intervenime më të mëdha. Nëse Ministria e Sportit dhe Komuna e Mitrovicës nuk na ndihmojnë, atëherë duhet të bëjmë improvizime. Ne kemi përvojë me improvizime, por duam të investojmë në palestër, në mënyrë që pajisjet të mbeten në palestër dhe shpresojmë se do

të kemi ndihmë nga institucionet e Kosovës", ka deklaruar Dushku. Ndërsa Granit Rugova ka folur për Përfaqësuesen A si dhe turneun e Kosovës U-20 në Maqedoninë Veriore. "Kemi hyrë në fazën finale të stërvitjeve, ku tri grupmosha janë vendosur në Prishtinë dhe më pas do të akomodohen edhe tri të tjera. Në mesin e muajt korrik do të grumbullohet edhe Kosova A, ku para ndeshjeve me Luksemburgun dhe Britaninë e Madhe do të zhvillojë edhe tri takime miqësore. Ndërkohë, ndeshjet miqësore të Kosovës U-20 kanë qenë të mirëseardhura. Edhe pse nuk mund të jemi të kënaqur me rezultatet, këto takime i shërbejnë për t'u përgatitur sa më mirë për Evropian. Kosova U-20 ka edhe tri javë kohë që të përgatitet sa më mirë për Evropianin në Portugali. Vullneti te këta djelmosha është shumë i madh dhe besoj shumë në këtë përfaqësuesë", ka thënë Rugova.

SHKURT

Istogu shtron drekë për hendbollistët e Kosovës

Përfaqësuesja U21 e Kosovës në Hendboll po vazhdon përgatitjet për kampionatin botëror të muajt të ardhshëm. Ushtrimet po zhvillohen në Banjë të Pejës, ndërsa atmosfera është shumë e mirë. Të hënën djemtë dhe shtabi teknik shfrytëzuan pushimin mes stërvitjeve për t'u qetësuar në qytetin e bukur të Istogut. Drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport i Komunës së Istogut, Drin Sadikaj, ka organizuar një pritje për lojtarët dhe shtabin teknik në restorantin "Trofta". Takimi me zyrtarët istogas është bërë në kuadër të bashkëpunimit dhe përkrahjes dhe, po ashtu, të përpjekjeve për ofrimin e kushteve sa më të mira për përfaqësuesen.

Newcasteli njofton largimin e Benitezi

Po përflitej prej kohësh dhe tani vjen edhe zyrtarizimi. Rafael Benitezi nuk do të jetë më trajner i Newcastle Unitedit. Diçka të tillë e njoftoi vetë klubi i Newcastleit, që me një postim në rrjetet sociale zyrtarizoi largimin e teknikut pas tre vjetësh. "Me zhgënjim të njoftojmë se Rafael Benitezi do të largohet nga Newcastle më 30 qershor për shkak edhe të përfundimit të kontratës", shkruante klubi anglez në faqen zyrtare në "Twitter".

Eto'o, Salahut: Shko te Barça

Samuel Eto'o e nje mirë La Ligan spanjolle dhe sidomos dy klubet kryesore: Barcelonën dhe Real Madrid. Afrikani ka folur në lidhje me Mohamed Salah, duke e nxitur egjiptianin të ndërrojë ekip. Për t'u bërë më i miri duhet të luash me Barcelonën dhe Eto e këshillon egjiptianin që të synojë këtë lëvizje. "Barça do të ishte maksimumi për Salah. Reali më dha mundësinë për t'u larguar nga Afrika, por nuk ka si Barcelona. Unë e njoh mirë stilin e klubit katalanas dhe mendoj se kalimi atje është më i miri për sulmuesin e Liverpoolit. Nëse Momo do të ketë mundësinë për të luajtur në kampionatin më të mirë në botë, që është ai spanjoll, ai duhet të transferohet te Barcelona. Atje ka mundësinë për t'u bërë një ndër më të mirët", thekson 38-vjeçari.

Milani synon De Rossin, Torreiran dhe Hernandezin

AC Milan po synon të përforcohet në mesfushë me Daniele De Rossin dhe Lucas Torreiran. Skuadra italiane do të luftojë edhe sezonin e ri për një vend në Ligën e Kampionëve, kurse sezonin që lamë pas përfundoi në vendin e pestë, e që do të luajnë sërish në Ligën e Evropës. Një tjetër lojtarë që po e dëshiron Milani për sezonin e ri është mbrojtësi i Real Madridit, Theo Hernandez.

Koulibaly: Besoj se do të qëndroj në Napoli

E ardhmja e Kalidou Koulibaly te Napoli nuk është e sigurt. Aurelio De Laurentis po reziston, por ofertat për "murin" e mbrojtjes janë të shumta. Flasin për shifra mbi 100 milionë euro, ndërsa presidenti kërkon të paktën 130 milionë. Lojtari po luan Kupën e Afrikës me kombëtaren e tij, aty ku Senegali e nisi me një fitore kundër Tanzanisë kompeticionin. "Të gjithë flasin për të ardhmen time, por unë e kam mendjen vetëm te Senegali. Objektivi im është që të arrij diçka të madhe me kombëtaren time. A do të qëndroj te Napoli? Nuk e di, por besoj se do të qëndroj. Nuk dua të flas për të ardhmen time, dua të flas për Senegalin tim. Jam 200% i përqendruar te Kupa e Afrikës, bashkë me 15 milionë senegalezët", ka thënë Koulibaly.


Vetteli dorëzohet në garën për titull

BERLIN, 24 QERSHOR - Vendi i pestë në garën e Francës dhe fakti se makina Ferrari për asnjë çast nuk arriti të duelojë me Mercedesin ka sjellë pesimizëm te Sebastian Vetteli. Piloti gjerman i "kokëkuqes" ka hequr përfundimisht dorë nga titulli kampion në Formula 1, duke u shprehur se rivaliteti me makinën Mercedes është i pamundur. Të paktën për momentin. "Vështirë të gjesh diçka pozitive nga kjo fundjavë. Leclerc u rendit i treti, ky është një ngushëllim i vogël. Gjithsesi, nuk jemi në gjendje të duelojmë me Mercedesin, kjo është e dukshme. Lewisi pati një tjetër garë të lehtë, kjo ndoshta edhe për fajin tonë. Makina Ferrari nuk është ende




mjaftueshëm e shpejtë", ka thënë Vetteli. "Unë e di që në Maranello punojnë fort, me shumë pasion, por edhe presion për të sjellë një Ferrari kompetitiv në garë. Shpresoj që në

Austri gjërat të shkojnë më mirë", u shpreh Vetteli, katër herë kampion bote në Formula 1, por asnjë titull me Ferrarin. Ai ka 76 pikë më pak se Hamiltoni në renditje.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit të Komunës
Udhëheqësi I Personelit/Rukovodilac Personalala/Head of Personnel

Nr. 111/010037929/19
Skenderaj, më 24 Qershor 2019.

Udhëheqësi i Personelit, duke u bazuar në nenin 3 paragrafi 2, nenin 11, paragrafi 1 dhe 2, nenin 12 paragrafi 3, nenin 18, paragrafi 1, nenin 20 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit mbi Shërbimin Civil nr.03/L-149, dhe Rregulloren nr. 02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në SHC si dhe pas autorizimit për shpalljen e konkursit nga MAP përmes SIMBNJ nga DASHC për pozitat e lira për një, Zyrtar i Lartë për Promovim të Kulturës -KRS/440 / JP00039567, më 24 Qershor 2019, vendosi të shpallë këtë:

K O N K U R S

Për plotësimin një (1) vend të lirë të punës në organet e Administratës të Komunës së Skenderajt.

Emri i Institucionit: Komuna e Skenderajt—Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport.
Pozita e punës: Zyrtar i Lartë për Promovim të Kulturës
Numri i Ekzekutuesve 1
Kodi Buxhetor: 85023
Kategoria funksionale: Profesional 2
Grada e vendit të punës: Koefficienti 7
Lloji i vendit të punës: I karrierës, më orar të plotë (40) orë.
Raporton: në Drejtorinë për Kulturë Rini dhe Sport.
Vend ndodhja: Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport.

-Përshkrimi i detyrave të punës: Kryen punën e përgjithshme të sektorit dhe ndihmon mbikëqyrësin në caktimin e objektivave dhe zhvillimin e planit të punës për përbushjen e objektivave, organizon aktivitetet kulturore dhe punë në ruajtjen, kultivimin dhe prezantimin e vlerave të trashëgimisë së kulturës materiale dhe shpirtërore, merret me realizimin e manifestimeve kulturore e artistike, shënimin e datave të rëndësishme kombëtare e ndërkombëtare dhe festivaleve tradicionale, ndihmon mbikëqyrësin në vlerësimin e proceseve dhe procedurave të brendshme dhe rekomandon ndryshime përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe cilësisë në punë, prezanton nevojat për investime kapitale në rehabilitimin dhe ngritjen e infrastrukturës kulturore dhe koordinon punën në realizimin e projekteve, harton plane për inkurajimin dhe mbështetjen e aktiviteteve të subjekteve në nivel lokal, inkurajon investitorët dhe sponsorët potencial në përkrahjen e skementit të kulturës, kryen edhe puna tjera që kërkohen kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.

Kualifikimi: Përgatitja profesionale: Diplome Universitare se paku 3 vite përvojë pune



- Përveç kushteve të parapara me ligj, kandidati duhet t'i plotësojë kushtet si në vijim:
- Një CV të shkurtër.
- Të këtë shkathësi dhe aftësi profesionale për këtë vend pune.
- Kandidati duhet të jetë i gatshëm të punojë nën presion dhe në shoqëri multietnike.
- Shkathësi dhe aftësi të mira komunikimi.
- Njohja e gjuhëve zyrtare.
- Kohëzgjatja e punës provuese 12 muaj, në bazë të Rregullores të MAP/DASHC nr. 02/2011.


Të interesuarit për këtë vend pune, aplikacionit duhet t'ia bashkëngjisin këto dokumente:

- Diplome Universitare – Diplome Universitare-Fakulteti Filologjik, Administrat Publike dhe Diplomaci, Politika publike dhe Menaxhment se paku 3 vite përvojë.
- Dëshmi për përvojën e punës.
- Certifikata e lindjes.
- Kopjen e letërnjoftimit të lëshuar nga MPB e Republikës së Kosovës.
- Certifikatën që nuk jeni të dënuar dhe nën hetime nga Gjykata.
- Kandidati/ja që pranohet në vendin e punës duhet të sjellë certifikatën mjekësore .


“Shërbimi Civil i Kosovës është në shërbim të gjithë qytetarëve të Kosovës, i cili i mirëpret të gjitha aplikacionet nga meshkujt dhe femrat të të gjitha komuniteteve të Kosovës” Aplikacionet mund të merren në Zyrën Pritëse (QSHQ) të Komunës së Skenderajt. Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në Zyrën Pritëse (QSHQ) të Komunës së Skenderaj, në kopje dhe mbetet në arkiv nuk kthehet, konkursi është i hapur në afat prej 15 ditësh, që nga dita e shpalljes së këtij konkursi në mjetet e informimit publik, në një gazetë të përditshme dhe në web-faqen e Komunës. Dokumentet e pakompletuara dhe ato që vijjnë pas afatit të konkursit, nuk do të shqyrtohen. Konkursi do të shpallet në të dy gjuhët.

Udhëheqësi i Personelit
Armend Gruda



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Udhëheqësi i Personelit-Kabinet Predsendika-Kancelarija Personala
Mayor's office staff leader

Br. 02-111/01-0037929/19
Skenderaj, 24 Juni 2019 g.

Rukovodilac personala na osnovu člana 3, stav 2, člana 11, stav 1 i 2, člana 11, stav 1 i 2, člana 12 stav 3, člana 18, stav 1, član 20, stav 1 i 2 Zakona o Javnoj Službi Kosova br. 03/L-149, Pravilnika br. 02/2010, za procedure regrutacije u javnoj službi, kao i ovlaštenju za objavljivanje konkursa o MJA preko ISMLJR iz DACS, za slobodno radno mesto Viši Službenik za Promovaciju Kulture KRS/440/ JP00039567, datum 24 Juni 2019 godine je odlučio je da objavljuje sledeći:

K O N K U R S
O POPUNJAVANJU JEDNOG (1) SLOBODNOG RADNOG MESTA U ORGANIMA SAMOUPRAVE SKENDERAJ

- Ime Institucije: Opština Skenderaj- Direkcija za Kulturę Omladinu i Sport;
- Naziv radnog mesta: Službenik za Promociju Kulture;
- Broj izvršilaca: 1
- Budžetski Kod: 85023,
- Funksionalna Kategorija : Profesional 2
- Stepen radnog mesta: koefficientat 7
- Tip radnog mesta: KARIJERE puno radno vreme (40) časova,
- Raportira: Direktor Direkcije za Kulturę Omladinu i Sport;
- Sedište: Direkcija za Kulturę Omladinu i Sport, Opština Skenderaj

Opis Radnih Zadataka: Izvršava opšte poslove za sektor, pomaže nadzornika za određivanje ciljeva i poštovanje plana rada, organizuje kulturne i radne aktivnosti za određivanje, čuvanje, obrađivanje i prikazivanje vrednosti kulturnog, materilnog i dušnog nasleđstva, bavi se sa realizacijom kulturnih i umetničkih manifestacija, zabeležavanje važnih državnih i međunarodnih datuma, tradicionalnih festivala, pomaže nadzorniku u sprovođenju procedura unutar organa i preporučava promena sa ciljem povećanja efikasnosti i kvaliteta poslova, prezentira potrebe potrebe za kapitalne investicije u rehabilitaciju u povećanju kulturne investicije koordinira rad za realizaciju projekata, izrađuje planove, pokušava ohrabriti eventualne investitore, izvršava i druge poslove po naređenju nadzornika.

Kavifikacija: Universitetska diploma, namanje 3 godine radnog iskustva

- Osim opštih uslova predviđene zakonom, kandidat mora ispuniti i sledeće uslove:
- Kratak CV;
- Da poseduje veštine i profesionalne sposobnosti za ovo radno mesto;
- Kandidat mora biti spreman da radi po pritiskom na multietničkoj društvi;
- Dobre sposobnosti za komunikaciju;
- Poznavanje službenih jezika;
- Trajanje probnog perioda 12 meseca, Pravilnika MJS/DACS br. 02/2011.



Zainteresovanih za ovo radno mesto, aplikaciji treba priložiti i sledeću dokumentaciju:


- Universitetska diploma, Filozofski Fakultet, Socijalni rad, Javna administracija i Diplomata, Javna Politika, Menagment naj manje 3 godine radnog iskustva.
- Dokaz o radnom iskustvu ;
- Rodjeni izvodi;
- Kopiju lične karte izdate od MUP-a Republike Kosova;
- Uverenje da nije kažnjen niti pod istragom od nadležnog Suda;
- Kandidat koji se prima na radno mesto, mora doneti i Lekarsko Uverenje.

“Civilna Sluzba Kosova je na usluzi svih stanovnika Kosova i poželjno očekuje aplikacije od muskaraca i žena od svih Zajednica Kosova”

Aplikacije se mogu dobiti u CUG-u (Arhivi) br. 1, u prostorijama opštine Skenderaj. Dokumentacija se predaje u CUG-u opštine Skenderaj, u roku od 15 dana od dana objavljivanja ovog konkursa na javnim srdstvima informisanja i ueb stranicu opštine Skenderaj/Srbica. Nekompletirana dokumentacija i ona koja dolazi posle roka konkursa neće se razmatrati. Predata dokumentacija neće se vratiti strankama, jedno kopije ostaje u Arhivi za dalji postupak. Konkurs se objavlja na oba jezika.

Rukovodilac Personalala:
Armend Gruda, s.r.






Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpeite

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156
+386 49 848 553

Prishtinë



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Republic Of Kosovo



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren-Municipality Of Prizren

Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural - Autoriteti Pyjor Komunal-Prizren

Nr.76/19 dt.19.06.2019

Në mbështetje të Ligjit për Pyjet e Kosovës 2003 /03 , ligji për ndryshim Nr.03/L-153 si dhe Udhëzimit Administrativ MA-Nr..06/2010 dhe 14/2011 lidhur me shitjen e trungjeve pyjore dhe asortimenteve drusore, si dhe vendimi i kryetarit të Komunës së Prizrenit Nr.01/060-82476 dt.19.06.2019

SHPALLË TENDERIN / ANKAND NR. 01/ 2019

Ftohen të gjithë Operatorët Ekonomik të licencuar , që janë të interesuara për blerjen e masës drunore në pyll (pa prerë) dhe, që të dorëzojnë ofertat e tyre për sasinë dhe asortimentin e evidentuar në tabelat e poshtëshënuara.

A). PLANI VJETOR PËR MENAXHIMIN ME PYJE PËR VITIN 2019 , DT.06.03.2019 DMP- 12/19, MBPZHR-APK.

Masa Drunore nëpër Njësi Menagjuse

Nr	Nj.mengjuse	Ngastra	Sip. Ha	Lloji drurit	Lloji trajtimit	Asort Bruto m ³	Asortimento ne neto m ³				mbeturi	Çmimi €
							Tek/trup Halor	Tek/Trup Fletor	Dru zjarri	Gjithsej		
1	Pashtrik I	127	11.0	Ahu	Rrallime	501.00		15.80	460.10	475.90	25.10	8.58
2	Pashtrik I	136	5.0	Bredhi	Rrallime	144.30	113.60	-	23.50	137.10	7.20	28.24
3	Malet e Sharrit	19	10.0	Ahu	Rrallime	172.80		21.50	142.60	164.10	8.60	11.00
4	Malet e Sharrit	38	8.0	Ahu	Rrallime	229.50	-	30.10	188.00	218.10	11.50	9.32
5	Koretник I	85	14.0	Ahu	Rrallime	281.50		25.40	242.00	267.40	14.10	10.80
6	Koretник I	102	8.0	Ahu	Rrallime	175.60		21.90	144.90	166.80	8.80	11.62
7	Gjithsej					1504.70	113.60	114.70	1201.10	1429.40	75.30	

Investimet sipas tenderëve për vitin 2019 , Hapja e shtigjeve dhe rrugëve në pyje , mirembajtja e rrugëve, punët silvikulurore, **keto mjete duhet të investohen në rrugë malore nga operatorët që shpallen fitus ekonomik dhe të parashihen me anex kontratë.**

Agjencia Pyjore e Kosovës
Agjencia za Šume Kosova
Kosovo Forest Agency
Drejtoria Koordinues Rajonal Prizren
Tel/fax: 029/210-383

AUTORITETI PYJOR KOMUNAL PRIZREN

Investimet sipas tenderëve për vitin 2019
Hapja e shtigjeve dhe rrugëve, Mirembajtja e rrugëve
punët silvikulurore

2019

Nr.	AP	NM	Ngastra	Vëllimi Tek/Zjarri m ³		Hapja e rruges-shtegut tek. zjarri		Mirëmbajtje e rruges-shtegut tek. zjarri		€/ m ³	Gjiths. €	Rrugët / shtigjet Gjiths.€	Silvik. €	Totali. €	
				tek.	zjarri	tek.	zjarri	tek.	zjarri						
1	Prizren	Koritniku I	85	25.40	3.50					3.50	88.9	935.9	401.10	1337	
				242.00		3.50				3.50	847				
2			Pashtriku I	102	21.90			3.50			3.50	76.65	583.80	250.20	834
					144.90			3.50		3.50	507.15				
3			M. e Sharrit	127	15.80	3.50					3.50	55.30	1665.65	713.85	2379.50
					460.10		3.50			3.50	1610.35				
4		M. e Sharrit	136	113.60			3.50			3.50	397.60	479.85	205.65	685.50	
				23.50			3.50		3.50	82.25					
5		M. e Sharrit	38	30.10	3.50		2.50			6.00	180.60	1308.60	327.15	1635.75	
				188.00		3.50		2.50	6.00	1128.00					
6		M. e Sharrit	19	21.50	3.00		2.00			5.00	107.50	820.50	246.15	1066.65	
				142.60		3.00		2.00	5.00	713.00					
			tek.	228.30											
			zjarri	1201.10											
			Gjithsej	1429.40							€ 5794.3	2144.10	7938.40		

Vërejtje : Keto mjete duhet të investohen në terren nga Op.ekonomik dhe të parashihen me anex kontratë. Prizren, Mars - 2019

Punoi:

Ekrem Krasniqi, Ing. i Pylltaris

Verteton:

Ali Buzhala, Ing. i Bujqësisë
Drejtor i DKR Prizren

T ë drejtë konkurimi kanë të gjitha firmat private që kanë licencën të lëshuar në pajtim me UA-03/2008 si dhe të regjistruar veprimtarinë e kultivimit dhe shfrytëzimit të pyjeve për pikën a), ndërsa të gjitha ndërmarrjet tjera për pikën b).

Ndërmarrjet duhet t'i ofrojnë dëshmitë për përmbushjen e të gjitha obligimeve tatimore, së paku deri në tremujorin e fundit para dorëzimit të tenderit.

Oferta duhet të jetë në pajtim me Udhëzimin administrativ 06 / 2010

Licencën e lëshuar në pajtim me UA-03/2008 (vetëm për ngastra pyjore)

- Emrin e Njësisë Menaxhuese, numrin e ngastrës dhe sasinë për të cilën paraqitet oferta
- Potencialin kadrovik dhe të mekanizmit në dispozicion për prerjen, tërheqjen dhe transportin e asortimenteve drusore, hapjen dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së rrugëve pyjore (vetëm për ngastra pyjore).
- Çmimin e ofruar për 1m³ të asortimenteve drunore veç e veç për dru zjarri dhe lëndë teknike.
- Dëshmi të lëshuara nga Njësia Komonale e Pyjeve -së ku aplikon, se kundër subjektit përkatës nuk ka të ngritur ndonjë procedurë për dëme pyjore.
- Referencë-dëshmi mbi kryerjen me sukses të punëve të realizuara nga kontratat e mëhershme në APK (nëse ka pasur) dhe nuk ka obligime të pa kryera.
- Dëshmitë për përvojat në kryerjen e aktiviteteve në shfrytëzimin dhe kultivimin e pyjeve
- Flet regjistrimin e ndërmarrjes, me veprimtarinë e kërkuar si më lartë
- Dëshmitë mbi kryerjen e obligimeve tatimore së paku deri në tremujorin e fundit para dorëzimit të tenderit.
- Afati kohor-dinamika e realizimit të punëve për ngastrën përkatëse.
- Dëftesa për pagesën e shumës prej 20 €, për pjesmarrje në ankand-tender.

Informatat detale për dhe vizitat nëpër çdo ngastrë pyjore mund të mirren-bëhen në Autoriteti Pyjor Komunal të Pylltaris në Prizren dhe të konsultohen lidhur me planet e kaludimit, për infrastrukturën rrugore e cila është e llogaritur dhe e kalkulime nga ekspertet e MBPZHR- DK-APK-PZ, në të cilin ka dalur edhe çmimi i fundit.

Ofertat e mbyllura në zyrë dorëzohen në sportelin nr 2 në objektin e administratës Komonale. Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është deri me datë 10. 07. 2019 në ora 13 30, ndërsa hapja do të bëhet të njëjtën ditë në ora 14:00.

Ofertat duhet të dorëzohen në zyrën e Perkurimit të Kuvendi Komunal në Prizren , dhe duhet të jenë të mbyllura.

Hapja e ofertave në pajtim me orarin e sipërcekur, do të bëhet nga komisioni.

2.antar nga .Autoriteti Pyjor Komunal Prizren dhe 1.antarë nga MBPZHR- DK-APK-j,Prizren,në prezence të ofertuesve, si dhe Hapjen e ofertave e bëjnë zyrtarët e përkurimit.

Të gjitha të drejtat dhe obligimet që dalin nga ky tender përcaktohen me Kontratë mesë Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural-Autoriteti Komunal Pyjor dhe fituesit të tenderit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Ministarstvo za Rad i Socijalne Zaštite
Ministry of Labour and Social Welfare



AGJENCIA E PUNËSIMIT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
AGENCIJA ZA ZAPOŠLJAVANJE REPUBLIKE KOSOVA
EMPLOYMENT AGENCY OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Bazuar në nenin 18 të Ligjit Nr. 03/L - 149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe në Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës shpall:

K O N K U R S

Titulli i pozitës së punës: Zyrtar për Shërbime të Punësimit (katër pozita)
Vendi: Zyra e Punësimit - Prishtinë; Referenca: RN00005113 (një pozitë)
Vendi: Zyra e Punësimit - Ferizaj; Referenca: RN00005116 (një pozitë)
Vendi: Zyra e Punësimit - Skenderaj; Referenca: RN00005112 (një pozitë)
Vendi: Zyra e Punësimit - Lipjan; Referenca: RN00005115 (një pozitë)
Institucioni: Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës
Lloji i pozitës: Të karrierës
Tipi i Akt Emërimit të punës: Orar të plotë pune
Titulli i mbikëqyrësit: Udhëheqës i Zyrës së Punësimit
Kategoria funksionale: Niveli Profesional
Grada/Koeficienti: Koeficienti - 6.5
Procedura e aplikimit: I jashtëm

Qëllimi i vendit të punës: Bën vlerësimin e nevojave të të papunësuarve dhe punëkërkuarve dhe siguron këshilla dhe informacione sipas nevojave të tyre për të ndihmuar të gjejnë punë; njëkohësisht ofron këshilla dhe informacione për punëdhënësit që kërkojnë punëtorë ose ndihmë tjetër lidhur me rekrutim dhe bën ndërmjetësimin në punësim.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Identifikon vështirësitë kryesore të të papunësuarit për punësim, interviston dhe regjistron klientët në SIMP.
